



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 189/1 Prot.

Tiranë, më 27.01.2025

V E N D I M

Nr. 23, Datë 27.01.2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 95, datë 03.05.2024¹, e znj. B.I, kundër z. B.B, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme², z. I.H, me detyrë Kryeadministrator, z. M.H, me detyrë Administrator i Sektorit të Administrimit Ekonomik-Financiar të Pasurive dhe znj. E.H, me detyrë specialiste finance, pranë Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjinisë”, “bindjes fetare”, “pamjes së jashtme” dhe “çdo shkak tjetër³”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi⁴,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në dokumentacionin e dërguar dhe me e-mail-in datë 12.05.2024, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “*Ushtrij Funksionin e Administratores së Pasurive pranë AAPSK, nga viti 2016, duke qenë Kontabël i Miratuar, Vlerësuese e Pasurive të Paluajtshme*”.

¹ Me e-mail-in datë 12.05.2024, ankuesja ka dërguar shtesë ankimi.

² Pretendim shtesë nga ankuesja me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 678/3, datë 10.06.2024.

³ Faktit që nuk bën kompromis në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Bashkëshorti i saj ka përfaqësuar me prokurë 11 administratorë pasurie, lidhur me shpërblimin e tyre për natyrë të veçantë pune dhe për shkak se ka bërë ankesë tek KMD.

⁴ Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD.

dhe Inspektore Financiare Publike. Financierja e këtij institucioni znj. E.H, për shkak se unë jam praktikante e fesë myslimane dhe mbaj shami në kokë, më ka bullizuar dhe ofenduar vazhdimisht duke më cilësuar me fjalët si, katundare, hajdute me shami dhe shumë fjalë bullizuese. Pavarësisht se jam bullizuar dhe diskriminuar, gjithmonë nga kjo punonjëse, asnjëherë ajo nuk e ka gjetur mbështetjen e drejtorëve të AAPSK-së. Pas komandimit në krye të kësaj Agjencie të drejtorit Z. I.H, znj. E.H ka gjetur mbështetjen e drejtorit, duke vazhduar të më fyejë në praninë e tij. I kam kërkuar me e-mail që të marrë masa ndaj financieres, e cila ka mbushur dhe moshën për pension dhe nuk del në pension, por drejtori nuk ka marrë asnjë masë, përkundrazi ka krijuar një komision për verifikimin e pasurive të cilat janë në administrim të AAPSK-së dhe anëtare komisioni ka vënë znj. E.H. I kam kërkuar skualifikimin nga komisioni pasi është rast skualifikimi, por ai nuk e ka hequr duke e lënë atë në komision qëllimisht që të më fyejë dhe të më bullizojë. Ajo duke qenë anëtare komisioni më ka fyer gjatë verifikimit të pasurive në sy të punonjësve dhe të anëtarëve të tjerë të komisionit, shkak për të cilin i jam drejtuar gjykatës me kërkesë penale për fyerje.

I kam parashtruar drejtorit Z. I.H ankesën dhe faktin e fyerjes së vazhdueshme nga kjo anëtare komisioni dhe ai ka vazhduar në të njëjtën situatë. Pasi kam marrë dijeni se drejtori Z. I.H ka ekzekutuar vendimin për ushtrim kontrolli vetëm ndaj meje, nga 12 administratorë pasurie që janë në AAPSK dhe vetëm ndaj meje janë bërë akt verifikime të falsifikuara nga anëtarët e komisionit, akt verifikime për të cilat unë kam bërë observacion. Z. I.H pa asnjë bazë ligjore ka kërkuar nga anëtarët e tjerë të komisionit dhe personeli përgjegjës në agjenci, observacion kundër observacionit të paraqitur nga ana ime. Jam ndjerë shumë e diskriminuar dhe kam menduar se ai i bën këto gjëra jo vetëm për shkak të veshjes sime me shami dhe besimit tim fetar, por edhe për faktin se unë nuk pranoj të bëj kompromis me të, jashtë luftës sime pa kompromis kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Ka ardhur grupi i kontrollit nga KLSH dhe vetëm dosjet e mia nuk janë marrë me përzgjedhje në kontroll, siç e parashikon ligji, por janë marrë në inspektim të gjitha dosjet që kam në administrim, duke u veçuar nga administratorët e tjerë, të cilëve u janë kontrolluar me përzgjedhje. Në raportin e KLSH-së janë supozuar dhe pretenduar shkelje nga ana ime për veprime dhe mosveprime që nuk janë veprime e mosveprime të miat dhe as kompetenca ime, duke u diskriminuar në këtë mënyrë nga z. M.H, shefi i Administrimit në AAPSK nëpërmjet gruas së tij (B.H.Z) që është Kryeaudituese në KLSH.

Drejtori i komanduar Z. I.H, ka urdhëruar ngritjen e grupeve të kontrollit dhe janë kontrolluar vetëm pasuritë e mia, duke fabrikuar akte verifikimi të falsifikuara dhe diskriminuese. Jam ofenduar vazhdimisht nga ana e financieres Znj. E.H, Z. I.H dhe Z. M.H në bashkëpunim, nuk është marrë asnjë masë për të ndaluar bullizimin, por përkundrazi është kaluar në diskriminim, ku pavarësisht se kam kërkuar përjashtimin e saj nga komisioni, drejtori Z. I.H nuk ka marrë vendim mbi kërkesën time por e ka lejuar të marrë pjesë në komision pa asnjë vendim. Jam ofenduar nga ana e financieres Znj. E.H dhe Z. M.H vazhdimisht, gjatë gjithë verifikimit të pasurive dhe drejtori sa herë ja kam bërë me dije e ka kaluar me qeshje ironike në praninë time, duke u tallur dhe qeshur pamjen time fizike për shkak të shamisë që mbaj në kokë, për shkak të besimit. Është

kaluar në akt verifikime të fabrikuara dhe të falsifikuara dhe kam bërë observacion për këtë, ndërsa Z. I.H u jep të drejtë të bëjnë dhe të shkruajnë kundër observacione duke u dhënë të drejtë pa asnjë bazë ligjore dhe të më diskriminojnë. Jam vënë në kushte të vështira në punën që unë bëj pa kompromis me krimin në AAPSK, për shkak të diskriminimit nga Z. I.H - Drejtor, Z. M.H - Shef administrimi dhe Znj. E.H - Financiere.

Së fundmi më është caktuar ndihmës administrator z. Gj.Xh, i cili ka arsim të lartë Gjeodezi. Kam kërkuar nga ai që të kryej detyrat në zbatim të rregullores së AAPSK-së, por nuk është kryer asnjë detyrë e ngarkuar nga unë si administratore. Këtu ju vë në dukje që unë kam në administrim vetëm pasuri të caktuara në emrin tim nga Prokuroria dhe Gjykata e Posaçme, ndërsa pasuritë që kanë ardhur në administrim të AAPSK-së, nuk kam asnjë në administrim që pas largimit të drejtuesit, z. A.K. Madje ka dhe vendime që SPAK më ka caktuar mua me emër si administratore dhe në rastet kur unë nuk kam marrë dijeni, titullari i institucionit pa ndryshuar vendimin e gjykatës dhe urdhrin e Prokurorit ka caktuar administrator tjetër si në rastin e Shoqërisë “Alesio” sh.p.k, për të cilin kam vënë në dijeni nëpërmjet e-mailit zyrtar prokurorët e çështjes, V.M dhe D.P.

Pas konstatimit nga ana ime të paligjshmërive të ndihmësit tim Z. Gj.Xh, i kam propozuar me e-mail drejtorit zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënies së punës, në mungesë të protokollit të brendshëm të AAPSK-së. Administratorët kanë kërkuar disa herë krijimin e protokollit të brendshëm, detyrë e lënë kjo, edhe nga auditimet në AAPSK, por me qëllim abuzimi nuk krijohet nga Kryeadministratori.

Jam vënë në dijeni në rrugë jo zyrtare që pas e-mailit për shkarkimin e ndihmësit Z. Gj.Xh, z. M.H ka propozuar dhe Z. I.H e ka miratuar kalimin e pasurive që unë kam në administrim nga SPAK, me urdhër ndihmësit tim Z. Gj.Xh, të cilit në mënyrë të paligjshme dhe në shpërdorim të detyrës, vetëm një javë më parë i kishte ndryshuar kontrata e ndihmësit, me propozimin e M.H, i cili ka marrë kompetencat e mia në lidhje me ndryshimin e kontratës së ndihmësit. Kjo sipas ligjit nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, të ndryshuar, është zgjidhje e menjëhershme e marrëdhënies së punës, duke kamufluar vendimin gjoja kam mbetur pa pasuri, kur edhe pas këtij vendimi atë ditë që u ballafaqova me drejtorin nën fyerje, ofendime, bullizime dhe përmendje të vazhdueshme në çdo fjali, të shamisë time në kokë.

Ju parashtroj, se emërimi i z. Gj.Xh është bërë në kundërshtim me ligjin, pasi nuk ka arsimin përkatës, pasi Urdhri i Ministrit të Brendshëm nr. 323, datë 02.10.2020 “Për përcaktimin e kritereve dhe rregullave për hartimit e listës të administratorëve të pasurive të sekuestruara, pranë Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”, sanksionon që administratori i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara duhet të ketë arsim të lartë ekonomik, me dije në fushën juridike ose arsim të lartë juridik me dije në fushën ekonomike.

Duke qenë se në AAPSK edhe nga ish-drejtuësi, janë marrë administrator me arsim të lartë në gjeografi dhe matematikë (jashtë listës së ekspertëve të dërguara në SPAK), Kontrolli i Lartë i Shtetit duke e konsideruar si shkelje të rëndë të ligjit, ka rekomanduar shkarkimin e titullarit.

Ndërsa në kundërshtim me sa më sipër, ka vendosur që pasuritë në administrimin tim nga SPAK, ti kalojnë në administrim Gj.Xh, me arsim të lartë Gjeodezi dhe jashtë listës së administratorëve të dërguar nga AAPSK.

Për sa më lart, janë bërë kundër meje për shkak të luftës sime pa kompromis kundër krimit dhe korrupsionit, për shkak se unë si administratore e di dhe e ndjej vështirësinë që kanë kolegët oficer dhe Prokurorët për marrjen e vendimeve të sekuestros dhe të konfiskimit, për shkak se unë në detyrën time ruaj pavarësinë dhe integritetin, për shkak se nuk prirem të shkoj e të rri gjatë në zyrën e drejtorit pa shkak, për shkak se pamja ime është me shami në kokë, për shkak se Z. I.H nuk i pëlqej, për shkaqe që nuk lidhen me punën time dhe as kualifikimin tim.

Për këtë arsye nuk kam pranuar asnjë lloj urdhri të paligjshëm të drejtuesve, të cilët herë pas here kanë kërkuar si më poshtë:

- 1. Marrjen në punë në bizneset që unë administroj të personave të ndryshëm që të pasqyroheshin në listë pagesë dhe të merrnin pagën pa u paraqit në punë.*
- 2. Të bëj kërkesa të panevojshme për vendosjen e rojeve fizike në pasuri, vetëm për pagesën e faturës së shoqërisë fizike që kishte fituar tenderin si rezultat i shkeljes së barazisë në tendera nga Z. M.H, duke sjellë në komision të tenderit një ofertues, me dokumente të falsifikuara dhe jashtë kushteve të dokumenteve standarde që kërkon tenderi. Ky fakt ka bërë që unë që pas asaj dite të dukem si delja e zezë në AAPSK dhe jam diskriminuar vazhdimisht dhe pandërprerë nga Z. M.H dhe Znj. E.H, ku ky titullar Z. I.H pavarësisht se unë i kam kërkuar të marrë masa për bullizimin në prani të tij, ai i ka caktuar në komisione kontrolli, të ngritura gjoja për të gjithë administratorët, por në fakt janë zbatuar vetëm tek subjekti im.*
- 3. Nga ana e këtij komisioni nën fyerje të vazhdueshme janë falsifikuar akte verifikimi, janë kryer veprime në pasuritë që janë sekuestruar, me të vetmin qëllim që t'ia arrijnë qëllimit që të paraqitet subjekti në zyrën e drejtorit për qokën e radhës, që në atë zyrë që kur ka ardhur Z. I.H, hyjnë e dalin subjekte të procedimeve pasurore, e cila është në kundërshtim të plotë me etikën e administrimit të pasurive dhe bie ndesh me luftën time pa kompromis kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.*
- 4. Titullari Z. I.H ka kërkuar nga ana ime të marr dhe të njoh Z. Gj.Xh, në të gjithë subjektet e procedimeve pasurore, por unë i kam thënë që Kryeadministratori, administratori dhe ndihmësi i tij (specialisti) nuk kanë asnjë të drejtë ndërmjetësimi me subjektet e procedimeve pasurore, por kanë vetëm administrimin e pasurisë duke ndjekur parimet thelbësore: Maksimizimin e të ardhurave dhe minimizimin e kostove.*
- 5. Titullari Z. I.H më ka detyruar të udhëtoj për ekzekutim, vetëm me ndihmësin Z. Gj.Xh, pavarësisht se unë ia kam bërë të qartë, kërkesën për të pasur një kolege femër pjesëmarrëse në ekzekutim, kërkesë e cila nga drejtuesit e mëparshëm ka gjetur mirëkuptim, duke marrë parasysh dhe besimin tim fetar”.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit, ndërprerjen e menjëhershme të diskriminimit nga ana e personave përgjegjës në AAPSK, trajtimin në mënyrë të barabartë me 11 administratorët e tjerë dhe kthimin në vendin e punës⁵.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar⁶, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 3, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

⁵ Kërkesë e bërë nga ankuesja me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 678/9, datë 16.08.2024.

⁶ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

- Me shkresën nr. 678/1, datë 21.05.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga subjektet kundër të cilëve është drejtuar ankesa, lidhur me pretendimet e subjektit ankues, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:

- Argumentimin Tuaj (z. I.H, z. M.H dhe znj. E.H), lidhur me pretendimet e subjektit ankues.
- Kopje të dosjes personale të ankueses (vendim emërimi, transferimi, kontrata pune, kopje të Librezës së Punës, vlerësim performance të tre viteve të fundit, etj).
- Kopje të vendimit të emërimit të z. I.H.
- Kopje të e-mail-eve të dërguara nga ankuesja, lidhur me pretendimet kundër znj. E.H dhe z. M.H dhe përgjigjet e dhëna nga ana e drejtorit z. I.H.
- Kopje të urdhrat për ngritjen e komisionit për verifikimin e pasurive në administrim të AAPSK dhe të detyrave dhe përgjegjësi të këtij komisioni.
- Informacion mbi kërkesën për skualifikim nga komisioni të znj. E.H dhe përgjigjes së dhënë.
- Kopje të plotë të relacionit/informacionit/observacionit të Komisionit të verifikimin e pasurive në administrim të AAPSK dhe të ankueses.
- Informacion mbi ushtrimin e kontrollit dhe për administratorët e tjerë të AAPSK.
- Informacion të plotë lidhur me pretendimin e ankueses për kontrollin e ushtruar nga KLSH.
- Kopje të dosjes personale të z. Gj.Xh (vendim emërimi, kontratë pune, etj).
- Kopje të komunikimit me e-mail të ankueses me z. I.H, lidhur me marrëdhëniet e punësimit të z. Xh.
- Informacion dhe kopje të dokumentacionit, lidhur me procedurën e kalimit të pasurive të administruara nga ankuesja tek z. Gj.Xh.
- Kopje të listës së administratorëve të pasurive të AAPSK.
- Kopje të Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e AAPSK”.
- Informacion nëse kjo çështje po ndiqet gjyqësisht. Nëse po, kopje të kërkesë padisë dhe parashtrimeve të AAPSK.

Me shkresën nr. 1977/1, datë 04.06.2024, subjektet: z. I.H, z. M.H dhe znj. E.H, drejtues dhe punonjës të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, në mes të tjerash informuan Komisionerin se: *“Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, në të gjithë veprimtarinë për përmbushjen e përgjegjësi të saj institucionale bazohet në parimet e mirëadministrimit, efektivitetit, efikasitetit, ekonomicitetit, transparencës, të ligjshmërisë si dhe shmangies, shpërdorimit e keqpërdorimit të pasurive që ka në administrim.*

Po kështu, në trajtimin e punonjësve të saj, AAPSK udhëhiqet nga parimi i integritetit, objektivitetit, meritës, transparencës, garantimit të zhvillimit të karrierës profesionale, barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit. Në këtë kuadër, edhe diversiteti gjinor i personelit të agjencisë, i bindjeve të tyre fetare, i pamjes së jashtme, si dhe i çdo aspekti tjetër, konsiderohet si një pasuri e institucionit dhe agjencia bën përpjekje të vazhdueshme për ruajtjen dhe kultivimin e këtij diversiteti, duke e normuar në aktet e saj dhe duke praktikuar në çdo aspekt të veprimtarisë së agjencisë.

Për realizimin e misionit të saj dhe përmbushjen e përgjegjësi, AAPSK drejtohet nga Kryeadministratori dhe është e organizuar në 3 sektorë: Sektori i Administrimit Ekonomiko-Financiar të Pasurive, Sektori i Marrëdhënieve me Institucionet dhe Çështjet Juridike dhe Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, punonjësit e të cilëve kanë statusin e nëpunësit civil.

Në varësi të numrit të pasurive që AAPSK merr në administrim dhe të natyrës së tyre, agjencia punëson personel administrator dhe ndihmës administrator, me kontratë, në bazë të Kodit të Punës, për administrimin e pasurive.

Në lidhje me objektin e ankesës së znj. B.I, vlerësojmë se ajo nuk është çështje diskriminimi apo diferencimi të saj nga drejtuesit apo nga personeli i agjencisë. Situata e znj. B.I përfaqëson një rast të pastër shpërdorimi detyre në ushtrimin e funksionit publik dhe të abuzimit e të shkeljeve të shumta në administrimin e pasurive. Ankesa e saj bëhet pas konstatimeve të shkeljeve të rënda nga ekipi auditues i KLSH-së në muajin tetor 2023 dhe të ekipit të kontrollit të AAPSK-së, në muajin shkurt-mars 2024, në pasuritë e administruara prej saj dhe masave të marra nga kryeadministratori, bazuar në rekomandimet që këto ekipe kanë bërë tek drejtuesit e AAPSK-së. Ankesa e saj tek institucioni Juaj, ashtu si dhe në disa institucione të tjera qendrore të ekzekutivit dhe në institucione të pavarura, e bazuar tërësisht në akuza pa fakte dhe në shpifje, vlerësohet se është vetëm presion për drejtuesit, stafin e AAPSK-së dhe për anëtarët e komisionit, shoqëruar edhe me kërcënime të hapura verbale.

Gjatë auditimit në pasuritë e administruara prej saj, janë konstatuar abuzime të rënda, në kundërshtim me kontratën individuale të punës dhe me parimet e mirëadministrimit të pasurive, të shoqëruara me dëm të konsiderueshëm financiar dhe në shumë raste përbëjnë elementë të veprës penale. Veprimet dhe mosveprimet e saj, duke i lënë pasuritë e sekuestruara apo të konfiskuara me vendim gjykate, në përdorim të personave të tretë dhe shpesh herë në përdorim të vetë subjekteve të vendimeve gjyqësore, duke lejuar përdorimin e paautorizuar dhe pa qira të pasurive, duke mos marrë në dorëzim pasuritë e sekuestruara, pjesë të vendimeve gjyqësore, pavarësisht identifikimit të tyre në kohën e ekzekutimit, janë vetëm disa nga shkeljet e saj.

Po sjellim në vëmendjen Tuaj vetëm disa konstatime të KLSH-së, në raportin me nr. 17/3, datë 04.10.2023, për znj. B.I ku citohet: "... ka kryer raportim të gabuar të gjendjes së ekzekutimit të vendimit", "... ka lejuar vendimmarrje nga subjektet kundrejt të cilëve është vendosur masa e sekuestros preventive", "ka zbatuar në mënyrë të parregullt zbatimin e kontratave të qirave....", etj. Gjithashtu, raporti përfundimtar i ekipit të kontrollit në AAPSK, në relacionin me nr. 717/8, datë 02.05.2024, ".... për shkelje të rënda të akteve ligjore e nënligjore, të rregullores së institucionit, të urdhrave të kryeadministratorit dhe të kushteve të kontratës së punës ...", ka propozuar zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës.

Në këto kushte, Kryeadministratori i AAPSK në ushtrim të kompetencave dhe përgjegjësi të tij ligjore, ka miratuar propozimet e grupit të kontrollit dhe ka marrë masa për heqjen e pasurive në administrim të saj, me qëllim ndërprerjen e abuzimeve me pasuritë dhe ndreqjen e situatës së krijuar. Gjithashtu, për veprimet dhe mosveprimet e saj, është bërë kallëzim penal në Prokurorinë

pranë Juridiksionit të Përgjithshëm të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, si dhe është vënë në dijeni dhe është angazhuar edhe Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion, pranë Ministrisë së Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Kryeadministratori i AAPSK.

Që nga data 12.02.2024, në krye të AAPSK-se me urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr. 40, datë 12.02.2024, është caktuar z. I.H, duke respektuar kërkesat dhe kriteret e pozicionit të punës për Kryeadministratorin dhe ato të ligjit për nëpunësin civil.

Bazuar në planin vjetor të AAPSK-së për kontrollin e pasurive, të miratuar me nr. 543, datë 07.02.2024, nga Kryeadministratori z. A.K, dhe në zbatim të tij, Kryeadministratori i caktuar në detyrë, z. I.H, me datë 23.02.2024, (email i datës 23 shkurt) ka njoftuar të gjithë administratorët, që me datë 26.02.2024, do të fillojë procesi i kontrollit fizik të pasurive në AAPSK. Udhëzime të njëjta u janë dhënë të gjithë administratorëve edhe për procesin e marrjes në dorëzim të pasurive, pjesë të vendimeve gjyqësore, nga Oficerët e Policisë Gjyqësore të Policisë së Shtetit apo të Byrosë Kombëtare të Hetimit (email i kryeadministratorit drejtuar të gjithë administratorëve, datë 05.03.2024).

Kontrollet fizike të pasurive, proceset e inventarizimit dhe radha e tyre, bazohen në problematikat e identifikuar nga ana e sektorëve të agjencisë në lidhje me administrimin, statusin e tyre si dhe në bazë të përgjegjësisë që agjencia ka për kontrollin fizik të pasurive që administrohen nga administratorët. Pasuritë objekt kontrolli dhe inventarizimi, janë të organizuara në bazë të vendimeve të gjykatave, apo nisur nga problematika të veçanta të identifikuar për pasuritë. Ky proces është dinamik dhe zhvillohet me tematika të veçanta. Në bazë të Urdhrit nr. 9, datë 08.01.2024, është planifikuar magazinimi i pasurive të luajtshme, në administrim të të gjithë administratorëve, në magazinën e AAPSK-së (bashkëlidhur urdhri i kryeadministratorit A.K për magazinimin e pasurive). Me datë 02.05.2024, në bazë të urdhrit të kryeadministratorit Z. I.H, është planifikuar procesi i inventarizimit të pasurive të sekuestruara në administrim të të gjithë administratorëve (bashkëlidhur relacioni, faqe e parë, me nr. 1338, datë 16.04.2024 dhe urdhri i Kryeadministratorit me nr. 249, datë 29.04.2024, për inventarizimin e pasurive në bazë të gjetjeve, që ka bërë ekipi i inventarizimit për vitin 2023).

Ky proces është planifikuar nga stafi i agjencisë dhe sektorët përkatës, është miratuar nga kryeadministratori, kanë dalë urdhrat përkatës dhe është komunikuar në takimet javore, me stafin e agjencisë dhe gjithë administratorët janë njoftuar me email nga ana e Kryeadministratorit dhe janë porositur në mënyrë të veçantë administratorët që të përshtatin maksimalisht agjendën e tyre në përputhje me planin e kontrollit të miratuar, pasi një proces i tillë vlerësohet si një nga mekanizmat kryesor, për monitorimin e miradministrimit të pasurive, efektivitetit të punës së agjencisë dhe si një mjet vetëkontrolli institucional.

Theksojmë se për shkak të numrit të madh të pasurive në administrim, të problematikave të shumta në lidhje me to, të numrit të vogël të personelit të agjencisë të angazhuar në ekipet e kontrollit, por edhe të angazhimeve të shumta që administratorët kanë me institucionet e tjera dhe nevojat e tyre për t'u paraqitur në institucione të ndryshme në kuadër të administrimit të pasurive, plani i miratuar jo gjithmonë zbatohet siç është planifikuar, duke sjellë nevojën për rishikimin dhe përshtatjen e afateve, por edhe të objektit të kontrollit të tij disa herë.

Siç vërtetohet më lart, kontrolli i pasurive për vitin 2024, inventarizimi i tyre dhe magazinimi i pasurive, është ndërmarrë ndaj të gjithë administratorëve dhe këto dokumente kryesore të agjencisë kanë planifikuar detyrime për të gjithë administratorët. Po kështu, çdo komunikim i drejtuesve të agjencisë dhe i çdo sektori në agjenci, në lidhje me kontrollin e pasurive është njoftuar në mënyrë publike tek të gjithë administratorët, duke hedhur poshtë çdo pretendim për diferencim mbi baza fetare, gjinore, etj.

Caktimi i ekipit të kontrollit në pasuritë që administrohen nga znj. B.I.

Bazuar në dokumentet kryesore, të përmendur më lart, në të cilët bazohet aktiviteti vjetor i AAPSK, me urdhrin e Kryeadministratorit nr. 117, datë 27.02.2024, të propozuar nga sektorët me përgjegjësi në kontrollin fizik të pasurive, është ngritur grupi për kontrollin e disa pasurive, pjesë e vendimit nr. 148, datë 29.09.2020, në administrim të znj. B.I me detyrë administratore e pasurive dhe z. Gj.Xh me detyrë ndihmës administrator i pasurive. Përbërja e ekipit, objekti dhe tematika e kontrollit, janë në urdhrin nr. 117, datë 27.02.2024 dhe në shkresën 717/1, datë 27.02.2024 (bashkëlidhur). Ju bëjmë me dije se në përbërje të ekipit të kontrollit janë caktuar dy përgjegjës sektori në agjenci, z. M.H, për administrimin ekonomiko-financiar të pasurive dhe z. Erion Ricku, për çështjet juridike, si dhe specialisti financës, z. Znj. E.H. Një përbërje e tillë e ekipit u bazua në funksionet që pjesëtarët në ekip mbajnë, funksione kryesore në agjenci, që kanë përgjegjësi në administrimin financiar dhe atë ligjor të pasurive dhe specialistja e financës për nivelin e ekspertizës në administrimin financiar të pasurive dhe të shoqërive tregtare që administrohen.

Në momentin e komunikimit për fillimin e procesit të kontrollit, është fakt që znj. B.I ka kërkuar verbalisht, me gojë, largimin e znj. E.H dhe të z. M.H nga ekipi i kontrollit, me pretendimin se ka konflikt interesi, por pa shpjeguar natyrën e këtij konflikti. Nga ana e kryeadministratorit, para fillimit të procesit të kontrollit dhe me marrjen e kësaj kërkesë është mbajtur takim në sallën e mbledhjeve, në ambientet e agjencisë, me personat e caktuar në ekipin e kontrollit dhe në praninë e znj. B.I, ku janë kërkuar sqarimet dhe janë, dëgjuar pretendimet e palëve rreth konfliktit të mundshëm të interesit. Gjithashtu, në këtë takim, nga ana e kryeadministratorit, u është kërkuar dy përgjegjësve të sektorit, nëse është e mundur rishikimi i përbërjes së ekipit, nisur nga kërkesa e znj. B.I, pavarësisht nëse ka apo jo argumente. Nga ana e anëtarëve të ekipit të kontrollit është deklaruar se nuk kanë konflikt interesi dhe për këtë kanë plotësuar deklaratën përkatëse (bashkëlidhur deklaratat). Nga ana e përgjegjësve të sektorëve, u argumentua pamundësia e zëvendësimit të tyre, për shkak të numrit të vogël të personelit dhe vakancave të shumta në

personelin e agjencisë. Në kushtet e moskonstatimit të gjendjes së konfliktit të interesit, nga ana e pjesëtarëve, ekipi filloi zbatimin e kontrollit.

Ju informojmë se nga znj. B.I nuk ka pasur ankesë dhe as pretendime për radhën e përzgjedhjes së pasurive objekt kontrolli dhe as pretendime se pasuritë e saj janë të vetmet që do të kontrollohen. Një proces i tillë u bë i njohur para gjithë administratorëve, se kontrolli do të ushtrohet në çdo pasuri, duke u bazuar në problematikat e identifikuara më parë.

Kryeadministratori, duke qenë në ditët e para të punës në këtë agjenci, miratoi planin dhe grafikun e propozuar nga sektorët përkatës me përgjegjësi në administrimin dhe kontrollin e pasurive.

Ju konfirmoj, se për shkak të kohës së shkurtër në detyrën e Kryeadministratorit dhe të mungesës së njohjes personale me znj. B.I, nuk ekzistojnë arsye dhe motive personale që udhëheqin sjelljen dhe qëndrimin institucional të Kryeadministratorit ndaj znj. B.I. Nga znj. B.I asnjëherë nuk është paraqitur dhe as drejtuar ankesë dhe as kërkesë verbale dhe as me shkrim, për mënyrën e qëndrimit dhe sjelljes në detyrë të kryeadministratorit ndaj saj.

Për më tepër, gjatë kësaj periudhe të shkurtër në detyrë të kryeadministratorit, çdo kërkesë e znj. B.I për largime para kohe nga puna, për mos paraqitje në punë, me arsyen e problemeve familjare, dhe nevojës së përkujdesjes për fëmijët e vegjël, janë plotësuar dhe miratuar nga ana e kryeadministratorit, pavarësisht mungesës së raporteve shëndetësore (ekzistojnë disa emaille dhe sms komunikimi), fakt ky i cili vërteton se jo vetëm që nuk është trajtuar me diskriminim, por është mirëkuptuar nga kryeadministratori.

Gjetjet e ekipit të kontrollit të AAPSK-së, në pasuritë e administruara nga znj. B.I.

Në përfundim të procesit të kontrollit të pasurive nga ana e ekipit të kontrollit dhe pas marrjes dhe konsiderimit të observacioneve të znj. B.I, ekipi i kontrollit i ka dorëzuar kryeadministratorit raportin përfundimtar të kontrollit dhe ka propozuar, ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës me agjencinë, për shkak “..... të shkeljeve të rënda të akteve ligjore e nënligjore, të rregullores së institucionit, urdhrave të kryeadministratorit dhe kushteve të kontratës individuale të punës, të shoqëruara me dëme të konsiderueshme financiare” (bashkëlidhur raporti përfundimtar mbi akt verifikimet e kryera nga komisioni me nr. Prot. 717/8, datë 02.05.2024 dhe observacioni i znj. B.I, me nr. Prot. 717/7, datë 28.03.2024).

Nga ana e ekipit të kontrollit janë konsideruar observacionet e znj. B.I, duke evidentuar gjithçka në raportin përfundimtar, pranimet dhe mospranimet e tyre. Nga ana e kryeadministratorit është diskutuar raporti dhe gjetjet me ekipin e kontrollit, i cili ka ardhur në zyrën e kryeadministratorit me datë 02.05.2024. Me datë 07.05.2024, është tentuar të thirret në takim dhe të jetë e pranishme edhe znj. B.I, për të diskutuar, në prezencën e saj dhe të ekipit, gjetjet dhe rekomandimet, por ishte e pamundur, pasi znj. B.I me marrjen e këtij njoftimi, u larguar nga agjencia dhe pas disa orësh njoftoi burimet njerëzore se ndodhet me raport mjekësor, regjim shtrati që nga data 08.05.2024, duke paraqitur raporte me afat 14-ditor fillimisht dhe 30-ditor më vonë në vazhdim të pandërprerë

pas 14 ditëve të para, duke e bërë të pamundur diskutimin e gjetjeve të kontrollit me znj. B.I, apo për të përcaktuar zgjidhjet e duhura, bazuar në gjetjet dhe rekomandimet.

Ju informojmë se znj. B.I vazhdon të jetë me raport mjekësor dhe që nga data 07.05.2024, për një periudhë 45 ditore, nuk paraqitet në punë, (bashkëlidhur raportet mjekësore të znj. B.I, për 14 ditë fillimisht dhe për 30 ditë në vazhdim të pandërprerë).

Nga ana tjetër, raporti mjekësor i njoftuar në agjenci, dyshohet për vërtetësinë e saj dhe janë marrë masa për konfirmimin e vërtetësisë, pasi znj. B.I, megjithëse është rekomanduar nga mjeku të respektojë kërkesat e regjimit të shtratit, rezulton të kryejë aktivitete dhe të ketë angazhime publike me datë 28 maj, periudhë që korrespondon me raport mjekësor (bashkëlidhur CD që konfirmon praninë e saj në aktivitete publike). Këtë veprim, znj. B.I e ka bërë vetëm për të mos kryer dorëzimin e pasurive, në bazë të masës së marrë dhe për të mos diskutuar gjetjet e raportit të kontrollit.

Aktualisht znj. B.I, vazhdon të jetë me raport mjekësor, në marrëdhënie pune me AAPSK, e vërtetuar nga kontrata e saj e punës bashkëlidhur me nr. 3213, datë 02.10.2023. Në dosjen e saj ka tre masa disiplinore, “Vërejtje” me nr. 1672, datë 19.05.2023, “Vërejtje me shkrim”, me nr. 4407, datë 26.12.2023 dhe “Vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga puna”, e dhënë me nr. 1771, datë 10.05.2024 (bashkëlidhur dosja personale dhe masat e marra).

Në këto kushte, kryeadministratori i agjencisë, duke u nisur nga mungesa e znj. B.I në punë për një periudhë 45 ditore, duke respektuar rekomandimet e ekipit të kontrollit për heqjen e pasurive nga administrimi i mëtejshëm i saj dhe me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore për administrimin e përditshëm dhe me eficiencë të pasurive në administrim të znj. B.I ka caktuar z. Gj.Xh, me detyrë ndihmës i znj. B.I të administrojë këto pasuri, deri në një moment të dytë (bashkëlidhur, Urdhri i kryeadministratorit për caktimin në detyrë të z. Xh, nr. 266, datë 07.05.2024).

Caktimi i përkohshëm i z. Xh në administrimin e këtyre pasurive është ofruar dhe vlerësuar si zgjidhja më e mirë, por edhe si mundësia e vetme për momentin, pasi ai njeh me mirë se kushdo tjetër në agjenci, dinamikën e këtyre pasurive duke qenë i përfshirë në bashkëadministrimin e tyre me znj. B.I, por edhe në kushtet e pamundësisë për të caktuar administrator nga jashtë agjencisë, duke ditur se procedura e shpalljes, konkurrimit dhe përzgjedhjes së personelit të ri merr kohë të gjatë, ndërkohë pasuritë kanë nevojë për administrim të menjëhershëm dhe të përditshëm.

Për caktimin e detyrave tek z. Xh, është njoftuar edhe znj. B.I me email, pasi nuk paraqitej në punë, duke qenë me raport mjekësor regjim shtrati. Për marrjen në dorëzim të pasurive nga z. Xh, është ngritur komisioni për këtë qëllim me urdhër të kryeadministratorit, (bashkëlidhur urdhri me nr. 35, datë 20.05.2024).

Për të përmbushur përgjegjësitë në administrimin e përkohshëm të pasurive, z. Gj.Xh është pajisur dhe pajiset çdo ditë me urdhrat e punës dhe me kredencialet e domosdoshme nga ana e

kryeadministratorit, që të përfaqësojë agjencinë në subjektet që ai menaxhon, të kryejë veprime në banka, në ASHK, dhe në institucione të tjera shtetërore. Këta urdhra të kryeadministratorit që caktojnë z. Xh në administrimin e pasurive apo në funksione përfaqësimi, lëshohen pasi kërkohen nga institucionet si akte juridike. Për këtë, janë njoftuar subjektet por edhe prokurorët.

Ju bëj me dije se agjencia ka një numër shumë të vogël administratorësh dhe ndihmës administratorësh, gjithsej 14, në krahasim me numrin e madh të pasurive që janë në administrim të cilat arrijnë numrin mbi 1100 pasuri. Çdo administrator është i mbingarkuar me pasuri. Nga ana tjetër, administrimi i pasurive të sekuestruara nga ana e AAPSK është kompleks, intensiv dhe me përgjegjësi.

Në të shumtën e rasteve, pasuritë dhe veçanërisht shoqëritë tregtare, siç është rasti i pasurive në administrim të znj. B.I dhe z. Gj.Xh, kërkojnë praninë e administratorit çdo ditë në pasuri/shoqëri, pasi ata janë autoriteti i vetëm për të kryer veprime financiare, marrjen e vendimeve administrative dhe përfaqësimin e AAPSK në asamblatë dhe bordet e menaxhimit të tyre, sipas vendimit të gjykatës. Administrimi i pasurive kërkon përgatitjen e raporteve të vazhdueshme për kryeadministratorin, prokurorin dhe gjyqtarin e çështjes nga ana e AAPSK, kërkon përfaqësimin në procese të ndryshme gjyqësore në të cilat pasuria mund të jetë objekt gjykimi. Administrimi i pasurisë kërkon angazhim të përditshëm të përfaqësuesit të agjencisë, administratorit apo ndihmës administratorit në marrëdhënie me institucione siç janë bankat, Qendra Kombëtare e Biznesit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor, etj.

Raportet e znj. B.I me z. Gjergji Xh.

Gjatë ushtrimit të detyrave të tyre institucionale në AAPSK, znj. B.I dhe z. Gj.Xh kanë raporte pune hierarkike, duke qenë se bashkëmenaxhojnë të njëjtat pasuri, në rolin e administratorit dhe të ndihmës administratorit.

Ju bëj me dije se gjatë gjithë periudhës së marrëdhënieve të tyre të punës në këto raporte, znj. B.I nuk ka shprehur pakënaqësi dhe nuk ka propozuar zgjidhjen e marrëdhënieve të punës për z. Gj.Xh.

Znj. B.I në email të datës 08.05.2024, dy ditë pasi kishte filluar raportin mjekësor, regjim shtrati, i ka propozuar kryeadministratorit nga shtëpia e saj, ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për z. Gj.Xh, vetëm pasi ka mësuar se z. Gj.Xh është caktuar për të administruar pasuritë deri në një urdhër të dytë.

Për propozimin e saj znj. B.I ka shfrytëzuar konstatimet e burimeve njerëzore në agjenci pas një kontrolli rutinë të prezencës në punë, të bërë me datë 23.02.2024, pra 3 muaj më vonë. Ju informojmë se as në rastin e konstatimeve nga ana e burimeve njerëzore, në muajin shkurt dhe as gjatë periudhës shkurt deri në muajin maj, znj. B.I nuk ka propozuar masa dhe as ka paraqitur ankesa, por ka vazhduar të punojë me z. Gj.Xh në kuadër të administrimit të pasurive (bashkëlidhur komunikimi me email mes znj. B.I dhe K/Administratorit datë 8 dhe 9 maj 2024).

Për më tepër, znj. B.I, me datë 20.02.2024, ka propozuar rinovimin e kontratës së punës me z. Gj.Xh, duke e vlerësuar maksimalisht, pra veprim konkludent, i cili tregon vlerësim pozitiv për ndihmësin (bashkëlidhur kërkesa e znj. B.I për rinovimin e kontratës të z. Gj.Xh, datë 20.02.2024 dhe kontrata e punës e z. Gj.Xh).

Në këto kushte, Ju bëj me dije se marrëdhënia juridike e z. Gj.Xh me AAPSK është ajo e mëparshmja, e përcaktuar sipas kontratës individuale të punës me AAPSK, në cilësinë e ndihmës administratorit të pasurive, pavarësisht detyrave të marra shitesë, përkohësisht.

Në lidhje me udhëtimin e znj. B.I vetëm me z. Gj.Xh në qytetin e Vlorës, për ekzekutimin e vendimit të gjykatës, ju informoj se nuk ka një kërkesë të paraqitur nga znj. B.I, për t'i dhënë edhe një person të tretë (në respekt të besimit dhe formimit të sajfetar). Në bazë të koordinimit të bërë me policinë e shtetit, në ekzekutimin e vendimeve, udhëtojnë së bashku personeli i agjencisë (administrator dhe ndihmës) dhe oficeri i policisë gjyqësore të Policisë së Shtetit, i tillë ka qenë edhe rasti i pretenduar nga znj. B.I. Edhe në kushtet e një kërkesë të tillë, mundësia e agjencisë për të siguruar gjithmonë person të tretë në makinë, në pasuri dhe në ushtrimin e detyrave të përditshme, vlerësohet e pamundur dhe e vështirë për t'iu plotësuar, pasi cenon mbarëvajtjen e përditshme të punës dhe detyrat funksionale, përgjegjësitë e secilit punonjës. Vetë natyra e punës pranë AAPSK është e tillë, ku punonjësit lëvizin në shërbime herë pas here në varësi të punës, fakt ky i cili vërtetohet nga autorizimet për shërbim.

Gjithashtu, kërkesën për udhëtim me shërbim duke përcaktuar grupin e punës e bën vetë administratori i pasurisë.

Marrëdhëniet e personelit të AAPSK dhe të z. M.H me znj. B.I.

Personeli i AAPSK nuk ka kultivuar marrëdhënie e raporte bullizimi me znj. B.I, nuk e ka diferencuar apo diskriminuar për shkak të veshjes e të pamjes së jashtme. Përkundrazi, marrëdhëniet e personelit të AAPSK-së kanë qenë më shumë se edhe marrëdhënie besimi ndaj saj, duke i qëndruar afër dhe duke e mbështetur në “veçoritë” e saj.

Për këtë, po sjellim vetëm një shembull të këtyre marrëdhënieve. Në muajin prill 2023, personeli administrator i pasurive në AAPSK, i besoi z. R.I, bashkëshort i znj. B.I me profesion avokat, përfaqësimin e tyre në gjykatë për një të drejtë të pretenduar nga ana e tyre, fitimin e vështirësisë në punë. Por është z. R.I, përfaqësues i znj. B.I këtë radhë, që me datë 10.05.2024, e keqpërdor këtë prokurë, duke tejkaluar tagrin e përfaqësimit, iu drejtohet disa institucioneve të ndryshme shtetërore në emër dhe për llogari të të gjithë administratorëve, dhe duke shprehur ankesa dhe akuza të ndryshme.

Pasi iu kërkuan sqarime dhe argumente personelit të administratorëve, nga ana e Ministrisë së Brendshme, të gjithë administratorët, deklaruan se nuk kishin dijeni për shkresat e drejtuara nga z. I në emër të tyre, nuk kishin lidhje dhe nuk ishin dakord me përmbajtjen e shkresave (bashkëlidhur praktika e kërkuar dhe e dërguar në Ministrinë e Brendshme dhe në departamentin

e bashkëqeverisjes). Me marrjen dijani të këtij veprimi, 11 administratorët (pasi një nga ata kishte shkëputur marrëdhëniet e punës) ia hoqën të drejtën e përfaqësimit, duke revokuar prokurën plotësisht. Vlerësojmë se janë raste të tilla, jo të denja nga znj. B.I që kanë cenuar dinjitetin, integritetin e tyre si dhe marrëdhëniet e besimit midis kolegëve.

Znj. E.H, specialiste e financës në AAPSK.

Znj. E.H ka filluar marrëdhëniet e punës në agjenci me datë 01.12.2015, me detyrë specialiste finance e buxheti, në bazë të vendimit të Departamentit të Administratës Publike. Ju informojmë se në DAP, ky funksion është shpallur i lirë për t'u plotësuar me datë 02.05.2024 dhe është në proces konkurrimi publik, proces që administrohet nga DAP (bashkëlidhur kërkesa e AAPSK për shpallje vakance dhe njoftimi i DAP me nr. 1630, datë 02.05.2024).

Ju bëjmë me dije se punonjësit me status të nëpunësit civil siç është edhe funksioni i znj. E.H, rekrutohen, administrohen dhe u ndërpriten marrëdhëniet e punës nga DAP.

Në lidhje me marrëdhëniet e znj. E.H me znj. B.I, nga e para është deklaruar se nuk ka asnjë konflikt interesi dhe nga ana e saj është bërë deklarata e konfliktit të interesit.

Caktimi i administratorëve të pasurive të sekuestruara.

Në nenin 9, pika 2.d, të ligjit nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Kryeadministratori cakton administratorët e pasurisë së sekuestruar me vendim gjykatë”. Edhe neni 11, pika 1 e këtij ligji, ka ndryshuar në vitin 2020 me anë të ligjit 19/2020, duke përcaktuar se: “Administratori i pasurisë së sekuestruar caktohet nga kryeadministratori i AAPSK”. Ndryshimet e vitit 2020, në ligjin 34/2019, ia kanë dhënë kompetencën kryeadministratorit të agjencisë për të caktuar administratorët e pasurive, në ndryshim nga përcaktimet ligjore të deriatëhershme dhe praktika e ndjekur kur administratorët caktoheshin nga gjykata. Në këto kushte, pretendimet e znj. B.I për mos dhënie në vitin 2021 të shoqërisë “Alesio” në administrim janë të pa baza, pasi është kryeadministratori ai që cakton administratorin e pasurisë. Theksojmë se për shkak të praktikës së mëparshme dhe të traditës, ka akoma raste të shkëputura që gjykatat e bëjnë pjesë të vendimeve të saj edhe emrin e administratorit, personel i AAPSK-së. Kryeadministratori i AAPSK, sipas planifikimit dhe në bazë të mundësive që ekzistojnë në agjenci, por edhe në bazë të ngarkesës që çdo administrator ka, si dhe në bazë të natyrës së pasurisë dhe të kualifikimit të administratorëve cakton administratorin e pasurisë dhe njofton gjykatën dhe prokurorinë përkatëse.

Lista e Administratorëve të pasurive të sekuestruara.

Në lidhje me pretendimin e znj. B.I se nga ish-drejtuksi i mëparshëm i agjencisë janë marrë administrator jashtë listës së ekspertëve të dërguar në SPAK, ju bëjmë me dije se nuk ka dhe nuk ekziston një listë ekspertësh e dërguar në SPAK dhe agjencia nuk detyrohet për një gjë të tillë në asnjë përcaktim ligjor.

Neni 9, pika 2.9 përcakton se Kryeadministratori i agjencisë “harton listën e administratorëve të pasurive të sekuestruara, të punësuar pranë agjencisë dhe ia paraqet gjykatës”. Në fakt, pas ndryshimeve ligjore të vitit 2020, ku caktimi i administratorit të pasurive të sekuestruara i kaloi për kompetencë kryeadministratorit të agjencisë, në ndryshim nga praktika e mëparshme që caktoheshin nga gjykata, ky përcaktim është gati i panevojshëm, pasi gjykata ngarkon agjencinë me administrimin e pasurisë dhe jo administratorë konkret. Në këto kushte, lista e administratorëve e njoftuar në gjykatë, është praktikisht lista organike e administratorëve që AAPSK ka në marrëdhënie pune (bashkëlidhur lista).

Auditi i Kontrollit të Lartë të Shtetit në AAPSK dhe gjetjet ndaj znj. B.I – tetor 2023.

Në muajin Tetor 2023, ekipi i auditit i KLSH-së ka ushtruar kontroll në institucionin e AAPSK, ku ndër pasuritë e audituara janë edhe ato që administroheshin nga znj. B.I. Bazuar në gjetjet dhe nisur nga një numër i madh shkeljesh e abuzimesh në administrimin e pasurive, nga ana e znj. B.I, KLSH, në raportin e tij për këtë qëllim, me nr. 17/13, datë 04.10.2023, Kreu E.1, pika 2, i ka dhënë masën disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra” (bashkëlidhur gjetjet dhe masa disiplinore e ekipit të KLSH-së për znj. B.I). Ju bëjmë me dije se gjatë procesit të auditit nga ana e KLSH, janë kontrolluar të gjitha pasuritë në administrim të AAPSK. Për çdo informacion shtesë në lidhje me këtë kontroll, mund të aksesoni raportin përfundimtar të auditit i cili është publik.

Zoti Komisioner,

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, vlerëson se rasti i znj. B.I nuk është rast bullizimi, diferencimi dhe as diskriminimi. Ky është një rast i shpërdorimit të detyrës, i problemeve të saj me ligjin dhe me kontratën individuale të punës”.

Me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 678/3, datë 10.06.2024, ankuesja ka nisur parashtrimet e saj, duke informuar si vijon:

“1. Ana formale e kthimit të përgjigjes nr. 1977/1 prot, datë 04.06.2024.

1/a. Rezulton se në shkresë janë vendosur disa nënshkrime pa treguar emrin, mbiemrin dhe cilësinë që ka personi nënshkruar. Shkresat zyrtare dalin nga institucioni dhe nënshkruhen nga titullari ose personi i autorizuar prej tij. Ndërhyrja në shkresën zyrtare e personave të tjerë, përbën falsifikim të dokumentit nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin, madje kur ndërhyrja është e fshehtë dhe nuk tregon personin që ka nënshkruar, duhet të hetohet edhe për qëllimin që ka pasur përpiluesi i shkresës zyrtare në këtë rast z. I.H, kur ka lejuar të nënshkruajnë edhe 3 persona të tjerë në shkresën zyrtare të AAPSK. Falsifikimi mund të kryhet me tri mënyra (nga ana objektive): I) duke ndryshuar një dokument origjinal (të rregullt), përmes pasqyrit të rrethanave të pavërteta; II) përmes prodhimit nga e para, të një dokumenti tërësisht të falsifikuar; III) përmes prodhimit të një dokumenti, që megjithëse formalisht është i rregullt, në përmbajtje përmban të dhëna që dihet se janë të pavërteta.

Në rastin konkret z. I.H, për të arritur qëllimin e paligjshëm, mbulimin e diskriminimit tim të hapur në punë, si para se të vijë drejtor i komanduar, ashtu edhe pasi ka ardhur drejtor, në shkresën që ju ka paraqitur ka sjell një shkresë të falsifikuar, si me ndërhyrje materiale të dukshme por të fshehura, ashtu edhe nëpërmjet falsifikimit intelektual, pasi ka përcjell në tërësi rrethana të pavërteta, duke qenë në dijeni të faktit që këto të dhëna janë të pavërteta, siç do të parashtrojmë me prova më poshtë në këtë parashtrim.

1/b. Shkresa i është dërguar për dijeni Sekretarit të Përgjithshëm, të Ministrisë së Brendshme, z. B.B, pavarësisht se në shkresën tuaj keni vënë për dijeni Ministrinë e Brendshme. Fakti që unë dyshoj që diskriminimi im ka ardhur si një politikë e diktuar nga struktura apo hallka hierarkike më të larta, në rastin konkret Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme, z. B.B, pasi jashtë-gjyqësisht, kemi marrë informacion që largimi im nga administrata publike, siç e parashtrohet edhe z. Idrizi në parashtresën e dërguar, ka qenë një kërkesë ndër të tjera edhe e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme. Pavarësisht se këtë z. Idrizi ja ka thënë një mikut të përbashkët, deri në marrjen dijeni të parashtrimit të AAPSK, nuk e kam ngritur si pretendim pasi e kam pasur ligjërisht të paprovuar. Fakti që Sekretari i Përgjithshëm nuk është institucion, por është Ministria e Brendshme institucioni, dhe shkresa i është vënë atij si person “nëpunës publik”, në rastin konkret ndeshemi me faktin “udhëzim për të diskriminuar”, që është një udhëzim apo kërkesë, bazuar në marrëdhënien hierarkike që z. I.H ka në punën që ka realisht, si Drejtor i Politikave në Ministrinë e Brendshme. Sqarojmë se AAPSK është organizatë shtetërore autonome në varësinë e Ministrisë së Brendshme dhe se Sekretari i Përgjithshëm nuk ka asnjë lloj kompetence mbi punonjësit e AAPSK. Kjo përforcon dyshimin tonë që personat përgjegjës, janë shtyrë nga ai (Z. B.B) për të më diskriminuar.

Duke konsideruar që me përgjigjen nr. 1977/1, datë 04.06.2024 të AAPSK, nuk është përmbushur informacioni i kërkuar nga Komisioneri, me shkresën njoftim dhe kërkesë për informacion, nr. 678/1, datë 21.05.2024, parashtrojmë si më poshtë.

2/a. Komisioneri i është drejtuar z. I.H, z. M.H dhe znj. E.H si nëpunës publik, dhe AAPSK-së. Komisioneri i ka kërkuar AAPSK të dërgojë dokumentet që i ka çmuar të nevojshme për hetimin administrativ, ndërsa ka kërkuar nga z. I.H, z. M.H dhe znj. E.H si nëpunës publik, prapësimet e tyre për sa ka parashtuar ankuesja për veprimet apo mosveprimet e tyre, të konsideruara diskriminuese nga ankuesja.

Duke qenë se unë jam vënë në dijeni nga punonjës të tjerë të AAPSK, që edhe raporti përfundimtar i ekipit të kontrollit në AAPSK, i pretenduar në shkresën që ka dërguar AAPSK pranë jush, është përgatitur pranë kompjuterit të shefit të sektorit me marrëdhëniet me institucionet, z. Erion Ricku, ku është ulur në mënyrë të vazhdueshme pas orës 13:00, vetë z. I.H duke punuar raportin përfundimtar, pasi kthehet nga Ministria e Brendshme. Komisioneri duhet të kryejë edhe një seancë dëgjimore, në ballafaqim me z. I. H, z. M.H dhe znj. E.H, me ankuesen.

2/b. Me shkresën “Njoftim dhe kërkesë për informacion”, nr. 678/1, datë 21.05.2024 Komisioneri ka kërkuar informacion të mjaftueshëm për bazueshmërinë apo jo të

pretendimeve të mia, ndërsa AAPSK ka sjellë informacion të rremë, dhe jo të gjithë informacionin e kërkuar.

- i. *Argumentimin tuaj z. I.H, z. M.H dhe znj. E.H, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.*

Nuk është sjellë asnjë argument në cilësinë e nëpunësit publik, por vetëm shkresa e AAPSK.

- ii. *Kopjet e dosjes personale të ankueses.*

Më rezulton që nuk është sjellë e gjithë dosja ime personale që administrohet në AAPSK. Në dosjen time personale janë të gjithë kualifikimet e mia, si Bachelor në Financë-UT, Master në kontabilitet-UT, kualifikimet pasuniversitare në fushën e Kontabilitetit, Financës dhe Administrimit Publik, Kontabël i Miratuar nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, Vlerësuese e Pasurive të Paluajtshme-UT, Inspektore Financiare Publike, me urdhrin nr. 5, datë 15.01.2021 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe kualifikime të tjera të cilat ndodhen në dosje dhe nëse nuk jua ka vënë në dispozicion AAPSK, ju lutem më njoftoni t’jua vë unë në dispozicion.

Në shkresën e AAPSK, citohet: “Në dosjen e saj ka tre masa disiplinore, “Vërejtje” me nr. 1672, datë 19.05.2023, “Vërejtje me shkrim”, me nr. 4407, datë 26.12.2023 dhe “Vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga puna”, e dhënë me nr. 1771, datë 10.05.2024”.

Në lidhje me këtë sqaroj;

Masa disiplinore “Vërejtje” me nr. 1672, datë 19.05.2023, është dhënë me pretendimin se nuk ndodhesha në institucion gjatë një kontrolli rutinë nga z. E.R, pas ankesës tek titullari mbi këtë masë, ku i kam relatuar me dokumente përkatëse zyrtare që kam qenë në punë jashtë zyrave të institucionit dhe ankesa ime është pranuar me urdhrin nr. 2023, datë 16.06.2023, të AAPSK ku është vendosur shfuqizimi i masës disiplinore në pikën 12 të këtij urdhri.

Masa disiplinore “Vërejtje me shkrim”, me nr. 4407, datë 26.12.2023, është dhënë përsëri gjatë një kontrolli rutinë datë 22.12.2023. Pas ankesës tek titullari mbi këtë masë, ku i kam relatuar me dokumente përkatëse zyrtare që kam qenë sipas autorizimit nr. 4360/1, datë 21.12.2023, urdhrit të shërbimit dhe kërkesës për shërbim në datë 22.12.2023, kam qenë për shërbim në Vlorë, ankesa ime është pranuar me urdhrin e AAPSK ku është vendosur shfuqizimi i masës disiplinore.

Këto dy urdhra shfuqizimi të masave disiplinore, qëllimisht nuk u janë vendosur juve në dispozicion, dhe në falsifikim të dokumentit nga personi që ka për detyrë të lëshojë aktin, është relatuar që unë kam masa disiplinore të mëparshme kur në fakt këto masa nuk janë në fuqi dhe nuk mund të citohen nga ana e titullarit.

Masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga puna” e dhënë me nr. 1771, datë 10.05.2024, është nja masë disiplinore absolutisht e pavlefshme e marrë në shpërdorim të detyrës nga ana e drejtorit Z. I.H.

Edhe në shkresën që ai vete ka dërguar pranon: “Gjithashtu, raporti përfundimtar i ekipit të kontrollit në AAPSK, në relacionin me nr. 717/8, datë 02.05.2024, “.... për shkelje të rënda të akteve ligjore e nënligjore, të rregullores së institucionit, të urdhrave të kryeadministratorit dhe të kushteve të kontratës së punës ...”, ka propozuar zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës.

Në këto kushte, kryeadministratori i AAPSK në ushtrim të kompetencave dhe përgjegjësi të tij ligjore, ka miratuar propozimet e grupit të kontrollit dhe ka marrë masa për heqjen e pasurive në administrim të saj”.

Pavarësisht se unë nuk jam vënë në dijeni të asnjë nga shkresat që citon AAPSK, si më sipër, vetë në shkresë citohet që: “Kryeadministratori i AAPSK në ushtrim të kompetencave dhe përgjegjësi të tij ligjore, ka miratuar propozimet e grupit të kontrollit dhe ka marrë masa për heqjen e pasurive në administrim të saj”.

Duke qenë se sipas Urdhrit nr. 287, datë 08.05.2024, ishte vendosur më parë zgjidhja e marrëdhënies së punës si administratore e pasurive të ankueses, urdhër i cili nuk më është vënë në dispozicion, por më është komunikuar me email si urdhër që është vendosur kalimi i pasurive të mia, administratorit të ri Gj.Xh.

Në këto kushte masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga puna” e dhënë me nr. 1771, datë 10.05.2024, njoftuar me email më datë 13.05.2024, është dhënë pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës siç parashtrohet edhe në shkresën e AAPSK, që po kundërshtojmë.

Kjo masë disiplinore është dhënë për të njëjtat shkaqe për të cilat është zgjidhur marrëdhënia e punës. Nëse i referoheni akt verifikimeve të grupit të kontrollit që po jua vë unë në dispozicion, që pavarësisht se janë të falsifikuara dhe të kryera në rrethana diskriminuese, kanë cituar të njëjtat, gjetje që janë gjetur edhe nga KLSH në raportin përfundimtar. KLSH-rekomandon “vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga puna”, AAPSK ka vendosur pa vendim, zgjidhjen e marrëdhënies së punës nëpërmjet heqjes së pasurive nga administrimi i ankueses tek administratori i ri Z. Gj.F.

Rezulton se në dosjen personale të kërkueses janë gjithashtu edhe performanca e saj në punë, që ka qenë shumë mirë në gjithë vitet e punës, përjashtojë vitin 2023 kur dhe ka filluar diskriminimi nga ana e z. M.H, pasi bashkëshorti i ankueses, mori për mbrojtje të drejtën për shpërblimin për natyrë të veçantë pune të administratorëve, e cila në fakt padrejtësisht i jepej z. M.H nga znj. E.H.

- iv. *Kopje të emaileve të dërguara nga ankuesja lidhur me pretendimet kundër znj. E.H dhe z. M.H dhe përgjigjet e dhëna nga ana e Drejtorit Z. I.H.*

Nuk më rezulton nga shkresa e AAPSK të jetë pretenduar ndonjë përgjigje, por vetëm justifikime të arsyeve për veprime dhe mosveprime të kryera në kundërshtim me ligjin nga z. I.H dhe z. M.H. Ndërsa as nuk është përgënjeshtuar e vërteta e provuar nga ana ime për komunikimet me email bashkëlidhur ankesës.

- v. *Kopje të urdhrit për ngritjen e komisionit për verifikimin e pasurive në administrim të AAPSK dhe të detyrave dhe të përgjegjësi të këtij komisioni.*

Rezulton se sipas Urdhrit nr. 117, datë 27.02.2024 është urdhëruar: “Kontrolli fizik i Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”, ndërsa në vetë urdhër është urdhëruar të krijohet komision për kontrollin e pasurive me administrator ankuesen. Nëse i referohemi komunikimeve me email bashkëlidhur, Kryeadministratori ka urdhëruar më parë në mbledhje, siç citon edhe në emailin e datës 23.02.2024 ku urdhëron që: “Administratorët detyrohen të vihen në dispozicion të ekipeve të kontrollit duke përshtatur axhendën e tyre në interes të mbarëvajtjes së procesit të kontrollit...”. Ndërsa Urdhri nr. 117, datë 27.02.2024 është vetëm për ankuesen dhe se është bërë duke caktuar në komision 3 anëtarët të cilët përveç se e kanë fyer dhe ofenduar disa herë në prezencë të drejtorit, por janë të tre në konflikt interesi të padeklaruar, duke krijuar deklarata të rreme për mungesën e konfliktit të interesit.

Siç rezulton edhe e pranuar nga shkresa e AAPSK, por edhe me akte të tjera, bashkangjitur këtij parashtrimi (prokurë e posaçme, ankim, ankesë tek bashkëqeverisja, kërkesë, kërkesë padi, etj), z. M.H, znj. E.H dhe z. E.R, kanë pasë të tre konflikt interesi pasi bashkëshorti i ankueses z. R.I, në cilësinë e avokatit ka qenë avokat mbrojtës i administratorëve kundër veprimeve të paligjshme të z. M.H dhe znj. E.H. Bashkëshorti im në cilësinë e mbrojtjes që ka bërë në institucionet e administratës publike dhe gjykata, e ka cilësuar falsifikim nga Z. M.H dhe Znj. E.H deklarin në sistem të administratorëve në kundërshtim me kontratën e punës, dhe se Z. E.R është paditur nga Sindikata e Ushqimit (klient që e përfaqëson bashkëshorti i ankueses) për deklarime të rreme të aseteve të shoqërisë së sekuestruar në administrim të Z. E.R, “Santa Quaranta Premium Resort”, për këtë konflikt që ankuesja ka pasë me Z. E.R, është njoftuar edhe ish-drejtuari A.K dhe pas një takimi që bashkëshorti im ka pasë me z. E.R në ambientet përballë zyrave të punës, i është kërkuar që mos merret më privatisht me ankuesen. Asnjë nga këto anëtarë komisioni nuk i kanë deklaruar këto shkaqe që përbëjnë konflikt interesi.

Pra në lidhje me deklarin e konfliktit të interesit anëtarët e komisionit nuk e kanë deklaruar marrëdhëniet e tyre me bashkëshortin e ankueses, për shkak të përfaqësimit që ky i fundit ka bërë gjatë ushtrimit të detyrës si avokat.

- vi. *Informacion mbi kërkesën për skualifikim nga komisioni dhe të përgjigjes së dhënë.*

Del e provuar, siç citohet në shkresë, që ka qenë në dijeni të konfliktit, dhe është mjaftuar me deklarimet e rreme të komisionit, ndërsa për znj. E.H kërkesa ime për skualifikim, del qartë që pavarësisht se i është përsëritur disa herë, si kërkesë verbalisht dhe me email, nuk ka një vendimmarrje konkrete, pavarësisht se i është nisur me shkrim në email, dhe bashkëlidhur edhe provat sipas nenit 31 i Kodit të Procedurës Administrative.

- vii. *Kopje të plotë të relacionit/informacionit/observacionit të komisionit të verifikimit të pasurive në administrim të AAPSK dhe të ankueses.*

Nuk kam dijeni nëse informacioni ju është paraqitur i plotë, pasi në institucion ka urdhër për kontroll fizik të pasurive, nr. 117, datë 27.02.2024, pavarësisht se thuhet për të gjithë pasuritë, ka dalë vetëm për mua, akt verifikime nr. 717/2 prot, 717/3 prot, 717/4 prot, dhe 717/5 prot, datë 25.03.2024, observacion timin nr. 717/7 prot, datë 28.03.2023, mbi këto akt verifikime bashkëlidhur observacionit provat që provojnë pavërtetësinë e akt-verifikimeve, falsifikimin e tyre dhe veprimet dhe mosveprimet e paligjshme që përbëjnë disa herë edhe vepra penale për anëtarët e këtij komisioni. (referojuni vetëm faktit që pavarësisht se verifikimi në terren është bërë në data të ndryshme, akt verifikimet mbajnë të njëjtën datë, dhe protokoll me fraksion), ndërsa për më gjerë referojuni observacionit dhe provave bashkëlidhur.

viii. Informacion për ushtrimin e kontrollit edhe për administratorët e tjerë të AAPSK.

Nuk ka asnjë informacion që ka bërë kontroll për administratorët e tjerë. Pavarësisht se nëse i referoheni raportit përfundimtar të KLSH, dhe observacionit të administratorëve të pasurive, u janë gjetur të njëjtat shkelje me ankuesen, të gjithë i kanë pretenduar si shkelje të z. M.H si shef i Administrimit, dhe se pavarësisht se disa herë për shkak të ngarkesës në punë, i kam komunikuar z. I.H të vazhdojë me administratorët e tjerë, ai më ka pezulluar nga çdo detyrë tjetër pavarësisht se ishin ekzekutime vendimesh të SPAK, që nuk prisnin kohë (ekzekutimi i vendimit të mikut të Z. I.H dhe Z. M.H, subjekti Z.H, fakt për të cilin u shpreh vetë subjekti në ekzekutim në prani të OPGJ dhe ndihmësit tim, topografit Z. Gj.F, duke shprehur: “.... Mua më ka thënë I.H se unë do të ti fal pasuritë, kur të vijnë tek unë, prandaj shtyjeni ekzekutimin”.

ix. Informacion të plotë lidhur me pretendimin e ankueses të kontrollit të ushtruar nga KLSH.

Nuk është i vërtetë fakti që u janë kontrolluar të gjithë pasuritë administratorëve të tjerë si në rastin tim, për këtë kërkon pasuritë që secili administrator ka pasë në administrim në kohën e kryerjes së kontrollit nga KLSH, dhe krahasoni me pasuritë e kontrolluara sipas raportit përfundimtar të publikuar. Por edhe në referim të ligjit, KLSH kontrollon dosje me përzgjedhje, mund të kërkon edhe faktin e vetëm dosjeve që kam pasë unë në administrim dhe sa nga ato janë kontrolluar, edhe vetë AAPSK në shkresën që ju ka dërguar e ka pranuar që janë kontrolluar të gjitha. Në fakt asnjë nga shkeljet e pretenduara nga KLSH sipas observacionit nuk është shkelje e imja dhe se kjo tregon edhe faktin e mos zbatimit nga drejtori i mëparshëm të rekomandimeve të KLSH.

x. Kopje të dosjes personale të z. Gj.Xh.

Nuk rezulton që shkresa të ketë bashkëlidhur, dosjen personale të z. Gj.Xh, përkundrazi, duke sjellë në shkresë të dhëna të pavërteta, është mjaftuar, duke sjellë kontratën si ndihmës administrator, dhe në kundërshtim me faktin, pretendojnë se ai po administron pasuritë përkohësisht si ndihmës administrator i ankueses, kjo në kundërtënie të email-eve të dërguara ankueses dhe pretendimeve në vetë këtë shkresë: “.... që duhet të paraqiteni për ti dorëzuar dosjet tek administratori i ri

Z. Gj.F, me urdhrin e kryeadministratorit nr. 266, datë 07.05.2024 është emëruar në një detyrë tjetër në AAPSK, duke u larguar nga varësia juaj funksionale dhe hierarkike”, dhe email-it të z. M.H: “.....shpenzimet e kryera për pagën do të ngarkohen tek kartelat e pasurive të z. Gj.Xh”.

- xi. Informacion dhe kopje të dokumentacionit lidhur me procedurën e kalimit të pasurive të administruara nga ankuesja, tek z. Gj.Xh.*

Nuk di të ketë bashkëlidhur shkresës që ju ka dërguar AAPSK, veprime komisionesh të pretenduara, nuk di të ketë ndonjë email ose komunikim të Z. Gj.F apo të Z. M.H e Z. I.H me mua, deri në datën 28.05.2024, apo ndonjë vështirësi në kalimin procedural të administrimit të pasurive që mund të asistojë pavarësisht se isha me raport. Në fakt unë iu kam relatuar me email z. I.H që Z. Gj.F po ndërhyr në dosje në mënyrë të paligjshme pa prezencën time dhe se z. I.H, më ka kthyer përgjigje që thjesht po i studion dosjet. Shoqëritë në administrimin tim e kanë vazhduar aktivitetit shumë në rregull, konform ligjit për shoqëritë tregtare, deri në datën kur unë u vura në dijeni nga financierët e shoqërive që është ndryshuar administratori në QKB. Z. I.H vetëm pas komunikimit tim që meqë më paske pushuar nga puna, duke shpërdoruar detyrën do të kthehem në punë me vendim gjykate, ai ka komunikuar mosparaqitjen time për dorëzimin e detyrës, kur nuk kam asnjë njoftim zyrtar për dorëzimin e detyrës, pasi nuk kam asnjë njoftim zyrtar as për ndërprerjen e marrëdhënies sime të punës, madje nuk kam pasë as dijeni deri në komunikimet me email të datës 20.05.2024 (datë kur pretendon se ka ngritur komision për dorëzimin e detyrës sepse nuk pranoja unë), ku përsëri nuk më është komunikuar ndonjë shkresë për ndërprerjen e marrëdhënies sime të punës dhe as ndonjë njoftim zyrtar për tu paraqitur për dorëzimin e detyrës. Të vetmen dijeni në rrugë zyrtare e kam nga komunikimet me email të datës 28.05.2024, nga shefi i sektorit Z. M.H, i cili kërkon të dorëzojë çelësat dhe dosjet e pasurive. Ndërkohë i kam komunikuar që çelësat i ke në sirtarin e punës në AAPSK, dosjet janë në protokollin e AAPSK, pasuritë që unë kam në administrim janë pasuri të paluajtshme dhe nuk i kam marrë me vete, shoqëritë janë atje ku e kanë selinë, llogaritë bankare janë në bankë, ndërsa ju më keni zgjidhur marrëdhënien e punës në kohë të papërshtatshme dhe në rrethana diskriminuese e në shpërdorim të detyrës. Drejtori ndërhyr duke pretenduar se nuk më ka zgjidhur marrëdhënien e punës, por mund të qëndrosh në një detyrë tjetër në AAPSK, pavarësisht se ai në shkresën që ju ka dërguar juve pretendon se unë kam shpërdoruar detyrën ku ai e quan ekstra ligjore “rast i pastër shpërdorimi detyre” dhe pretendon se më ka bërë kallëzim penal, e si mund të thotë njëkohësisht një drejtor që do angazhohesh në detyrë tjetër, përveçse ai kërkon të fshehë diskriminimin e ankueses për arsyet e parashtruara në ankesë.

- xiii. Kopje të rregullores së Brendshme, për organizimin dhe funksionimin e AAPSK.*

Akoma në AAPSK nuk ka një rregullore të miratuar nga ministri.

- xiv. Informacion nëse kjo çështje po ndiqet gjyqësisht.*

Pretendimi “se do i bëjnë kallëzim penal për shpërdorim detyre”, është një presion që i bëhet ankueses që ditën që ka ardhë z. I.H, Drejtor i komanduar në AAPSK, por nëse e bëjnë e sigurt

që është një kallëzim i rremë penal, dhe se tani e kanë formësuar siç duket në mendje pas kallëzimit penal që u ka bërë ankuesja, edhe për sekuestron ekzekutive, në bashkëpunim me përmbaruesin nga llogaria e shoqërisë së sekuestruar ku janë kryer akt verifikimet e grupit të kontrollit, të shumës prej 52 mijë euro. Bashkëngjitur gjeni kallëzimin penal, të urdhëruar nga drejtuesi i SPAK.

3. Argumenti jonë mbi pretendimet e AAPSK.

Në trajtimin e punonjësve të saj, pas ardhjes në drejtim të AAPSK, drejtori i komanduar z. I.H nuk udhëhiqet nga parimi i integritetit, objektivitetit, meritës, transparencës, garantimit të zhvillimit të karrierës profesionale, barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit, siç pretendon dhe se nuk dihet kush ka nënshkruar në të, anën formale të së cilën e kemi kundërshtuar më sipër.

Që kur z. I.H ka ardhur në AAPSK, më ka detyruar të përdor një gjuhë verbale, rezultat i një presioni të vazhdueshëm kundrejt meje, si ai personalisht, ashtu edhe me komisione anti ligjore, duke përdorur punonjësit e moshuar, të cilët kishin mbushur moshën e pensionit, me qëllim që mua të më detyronte të përdor dhunën, por unë e kam mbajtur veten, pavarësisht se çdo ditë kam pasë dhunë psikologjike të vazhdueshme, gjë e cila tregohet edhe nga keqësimi i gjendjes sime shëndetësore ku diagnoza është neurologjike (bashkëngjitur gjeni raportet mjekësore).

Administratorët dhe ndihmës administratorët nuk janë pjesë e strukturës së AAPSK, ndryshe sa citon shkresa nuk janë personel i AAPSK. Pasi për të qenë personel i një institucioni duhet të jesh pjesë e strukturës. Administratorët e pasurive janë pjesë e një liste të hartuar sipas urdhrit të ministrit të brendshëm nr. 323, datë 02.10.2020 “Për përcaktimin e kriterëve dhe rregullave për hartimin e listës së administratorëve të pasurisë së Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara”, të cilët pavarësisht se ushtrojnë detyrën mbi bazën e një kontrate pune sipas Kodit të Punës, kanë cilësinë e ekspertit të autorizuar nga organi procedues ose AAPSK. Ndërsa ndihmës administratori është specialist jashtë listës së hartuar që merret në punë në pasurinë që ka administratori në administrim.

Ndryshe sa pretendon AAPSK, në shkresën plot me pretendime të rreme, ankesa nuk është bërë pas konstatimeve të shkeljeve të rënda nga ekipi auditues i KLSH-së në muajin tetor 2023, për këtë raport ajo është ankuar në KLSH dhe se akoma nuk ka marrë përgjigje.

Ndërsa ankesa është bërë për shkak të mos marrjes së masave për ndalimin e fyerjeve të vazhdueshme edhe në prani të titullarit, nga znj. E.H. Fyerjeve dhe sharjeve në adresën time dhe të familjes sime me zë, nëpër korridoret e AAPSK, ku drejtori e vendos atë dhe M.H në ekip të kontrollit të AAPSK-së, në muajin shkurt-mars 2024, në pasuritë e administruara prej ankuses dhe përpara marrjes së masave nga kryeadministratori.

Kryeadministratori deri në datë 29.04.2024 nuk kishte marrë asnjë masë ndaj meje. Madje nuk kishte akoma as relacion për zgjidhje të marrëdhënies së punës, i cili nuk ishte përgatitur nga grupi i kontrollit, dhe mban nr. 717/8, datë 02.05.2024. Duket qartë që AAPSK, ka vazhduar me

urdhra të paligjshme pasi unë u kam thënë që për dhunën e vazhdueshme psikologjike dhe ofendimet kundrejt meje, do jepni llogari para Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Nga ana e AAPSK janë bërë kontrole të herë pas hershme të pasurive në administrim dhe nga momenti i marrjes në administrim të pasurive të kontrolluara me komisionin diskriminues, nuk është gjetur asnjë shkelje, përkundrazi jam vlerësuar me performancë shumë mirë dhe për arsye të performancës së shkëlqyer në punë me kontratën e punës nr. 3213, datë 02.10.2023, menjëherë pas kryerjes së kontroleve të të gjithë pasurive të miat, është rritur paga ime për performancë të shkëlqyer në kryerjen e detyrës. Ndërsa AAPSK duhet tu sjellë edhe të gjithë kontratat e mia, pasi unë e ushtroj detyrën nga muaji qershor 2016 në AAPSK, si administratore e pasurive.

Në lidhje me gjetjet e KLSH, masa e rekomanduar nga KLSH, nuk është dhënë nga titullari pasi është gjetur i pabazuar pretendimi i KLSH, drejtori i komanduar z. I.H për këto veprime edhe për veprime të miat, deri me datë 10.05.2024, ka dhënë masën disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra”.

Në fakt relatoj se kallëzimi penal në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm të Tiranës dhe ankesat në Drejtorinë e Përgjithshme Antikorrupsion, pranë Ministrisë së Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Prokurorinë e Posaqme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar janë bërë nga ana e ankueses, jo për shkaqet e diskriminimit, por për shpërdorim detyre, korrupsion, shkelje të barazisë së pjesëmarrjes në tender dhe pengim të ekzekutimit të vendimit të gjykatës, të kryer nga z. I.H dhe z. M.H në bashkëpunim.

Procedura e kontrollit të pasurive për vitin 2024 nga ana e drejtorit z. I.H, është bërë pas ankesës sime tek Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për veçimin tim me kontrole, pavarësisht se ai dërgon email për kontroll tek të gjithë administratorët, urdhri është me emër vetëm për mua. Nuk ka asnjë urdhër me emër tjetër administratori, deri në datën e depozitimit të ankesës sime tek KMD. Megjithëse z. I.H është përpjekur të fshehë veçimin e hapur të ankueses në kontrole, duke përdorur akte dhe relacione që nuk lidhen me kontrole, por me inventarizime, pavarësisht nëse janë apo jo të vërteta, nuk mbulojnë veçimin e ankueses me kontroll të pretenduar për të gjithë administratorët, por të kryer vetëm ndaj saj.

Drejtori i AAPSK, nuk thotë të vërtetën kur relaton se ka mungesë punonjësish për rishikimin e përbërjes së grupit të kontrollit të kontestuar nga ankuesja për konflikt interesi, pasi në fakt në AAPSK, ka punonjës më të vjetër në detyrë dhe që kanë mbajtur edhe detyrën e Drejtorit të komanduar disa herë si, z. Q.Th, ka punonjës korrekt dhe që janë personat përgjegjës të pasurive si z. S.S (specialist i marrjes në dorëzim të pasurive), z. E.K (specialist i të ardhurave dhe shpenzimeve nga pasuritë e sekuestruara dhe konfiskuara), znj. S.I (specialiste Juriste e AAPSK), znj. O.H (specialiste e marrëdhënieve me insititucionet), etj, por edhe nëse mbaronin punonjësit korrekt të AAPSK, ka Ministria e Brendshme auditues me eksperiencë, dhe punonjës

korrekt, por z. I.H ka plotësuar dëshirën e znj. E.H dhe z. M.H, pasi ka qenë në të njëjtën linjë diskriminimi.

I nderuar z. Komisioner!

Përveç se drejtori Z. I.H i përziën deklaratimet personale si Z. I.H, me institucionin e AAPSK, pasi në të njëjtën shkresë ku flet AAPSK, flet edhe në vetën e parë si Z. I.H, ai edhe gënjen hapur në shkresë, kur citon se me ankuesen Znj. B.I, ka mungesë të njohjes së tij personale. Ankuesja ka qenë përfaqësuese e AAPSK në të gjitha takimet e zhvilluara, ku z. I.H ka qenë përfaqësues i Ministrisë së Brendshme, sipas urdhrat të Kryeministrit nr. 94, datë 20.05.2019 “Për ngritjen përbërjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstitutionale të punës për integrimin evropian”. Madje ankuesja dhe Z. I.H janë njohur që në këto organizime dhe nuk kishte pse ta mohonte. Bashkëlidhur komunikimet me emailë zyrtare ku është në grup email edhe Z. I.H, ankuesja dhe Z. I.H kanë qenë anëtarë të të njëjtit Grup Ndërinstitutional të Punës për Integrimin Evropian.

Sqaroj se nëse i referoheni ditës në të cilën jam detyruar të udhëtoj vetëm me z. Gj.Xh për ekzekutim në Himarë në datë 17.04.2024, po atë ditë i kam kërkuar me email Drejtorit Z. I.H, që të më vendosë në dispozicion sipas ligjit përgjegjësin e sektorit, specialistin e marrjes në dorëzim ose në mungesë të këtyre një administrator, pasi i kisha komunikuar verbalisht disa herë shqetësimet seksuale të z. Gj.Xh, i cili përpara kësaj date ka qenë së bashku me ankuesen në një takim zyrtar në sallën e mbledhjeve në prezencë të z. M.H me datë 18.03.2024, ku z. Gj.Xh pas ankesave të mia për të, i kërkoj drejtorit që të mos jetë më ndihmës i imi. Pas këtij momenti ka filluar edhe për inat, procedura që ti kalojnë pasuritë e mia Z. Gj.Xh, në prezencën time i tha M.H, njeri nga këto të dy të largohet, duke nënkuptuar që ai nuk e pranon faktin që një femër të mos i nënshtrohen një mashkulli. Diskriminimi për shkak se unë kam qenë femër, ka vijuar edhe duke më thënë që ti nuk vjen në zyrën time të këshillohesh, vajzat e tjera më pyesin edhe për presjet, nuk është e lehtë për mua të merrem me ty për shkak të asaj që ti përfaqëson të gjitha këto fyerje, ishin në të njëjtën frymë me E.H e cila thoshte që ajo e mban kot shaminë dhe disa herë për punonjëset e tjera është shprehur: “Me një të kërcyer për vit të ri, e fitoi udhëtimin në serbi”.

Lidhur me përfaqësimin e personelit administrator të pasurive në AAPSK, nga ana e bashkëshortit të ankueses informoj se, prokura e posaçme është dhënë nga administratorët e pasurive kundër z. M.H dhe znj. E.H, të cilët janë ankuar për pagën dhe deklaratimin në sistem jo si administratorë pasurie por si administrator të dhënash, jurist, ekonomist, etj, pagesë të cilën aktualisht e përfiton z. M.H si rezultat i veprimeve të znj. E.H, veprime të cilat nga ana e avokatit janë cilësuar si të paligjshme dhe për këtë është bërë ankesë në bashkëqeverisje që në datë 04.12.2023, dhe kërkesë padi në gjykatë që në prill 2023. Pra bashkëshorti i ankueses ka qenë në konflikt për shkak të mbrojtjes së tij kundër z. M.H dhe znj. E.H, që me ankesën e tij. Bashkëshorti i ankueses pasi është njoftuar nga klientët e tij që po u bëjnë presion atyre për revokimin e prokurës me ardhjen e z. I.H, ka shkuar në zyrën e drejtorit më datë 8 maj dhe i ka kërkuar të mos u bëjë presion administratorëve të revokojnë prokurën, por të rregullojë falsifikimet që bën Z. M.H dhe Znj. E.H, për këtë ka pasë edhe një protokoll në këtë datë.

Pasi drejtori i ka thënë bashkëshortit të ankueses që ti mos u merr me ato, po shih se do të t'ja heq gruas tënde pasuritë, ai është larguar dhe ka bërë ankesë të ndalohej ky presion, për të ndaluar kërkimin e të drejtës së pretenduar nga administratorët e pasurive. Del qartë se edhe vetë AAPSK në këtë shkresë e pranon faktin që me marrjen dijani të këtij veprimi, 11 administratorët ia hoqën të drejtën e përfaqësimit duke revokuar prokurën plotësisht.

Por si në të gjithë shkresën edhe këtu z. I.H mashtron, pasi të paktën njëri nuk e ka heq prokurën që është bashkëshortja e avokatit, por edhe njëri administrator që është larguar e nuk i ka bërë dot presion, duhet të mbesin 9. Por pavarësisht se bashkëshortit të ankueses av. R.I akoma nuk i është njoftuar nga klientët, revokimi i prokurës sipas ligjit, ai deri tani edhe me administratorë të tjerë që janë në punë i kanë thënë, që pavarësisht presionit të z. I.H ne nuk ta heqim prokurën”.

Me email-in datë 21.06.2024, ankuesja ka parashtruar si më poshtë: “Unë jam avokat R.I caktuar me prokurë⁷ nga ankuesja Znj. B.I, bashkangjitur gjeni edhe prokurën e posaçme.

Rezulton se ankesa e znj. B.I është paraqitur pranë jush me datë 03.05.2024, dhe është regjistruar me nr. 95 ankesë, ndërsa shkresa nr. 1977/1, (datë 04.06.2024 e AAPSK), veç sa kemi parashtruar në parashtrimet tona, rezulton se përmban veprime që janë ndërmarrë ndaj ankueses pas paraqitjes së ankesës nga ana e saj. Këto veprime janë ndërmarrë si hakmarrje ndaj saj pse ka paraqitur ankesë, dhe në të gjithë këto veprime tregojnë qartë sjelljen diskriminuese të Drejtorit Z. I.H. Ankuesja është në gjendje të rënduar shëndetësore, gjendje e cila sa vjen e rëndohet si rezultat i traumës së rëndë që ajo ka pësuar nga sjellja shumë diskriminuese e personave përgjegjës. Personat përgjegjës në vend që të ndalonin diskriminimin por kanë vazhduar derisa me datë 07.05.2024, ankueses i bie të fikët në vendin e punës dhe shkon urgjent në spital ku i është diagnostikuar dhe po ndiqet nga mjekë neurologë dhe psikologë.

Ndërkohë që nga ana juaj nuk dimë nëse është administruar ndonjë mbrojtje apo parashtrim nga ana e personave: z. I.H, z. M.H dhe znj. E.H, kemi kërkuar edhe një ballafaqim me këto persona në praninë tuaj në një seancë publike dhe nuk kemi përgjigje”.

Me shkresën nr. 678/4, datë 24.06.2024, Komisioneri ka vënë në dijeni z. I.H, z. M.H dhe znj. E.H, lidhur me kundërshtimet e ankueses, si dhe ka njoftuar z. B.B, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme, lidhur me pretendimin për diskriminim të bërë nga ankuesja.

Me shkresën nr. 1977/3, datë 05.07.2024, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, në mes të tjerash informuan Komisionerin se: “Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 1977/1, datë 04.06.2024, kemi kthyer përgjigje shteruese dhe vënë në dispozicion të gjithë provat e nevojshme shkrese që kanë lidhje me kërkesat ankimore të palës ankuese.

Pas trajtimit me prioritet dhe me përgjegjësi të të gjitha çështjeve të parashtruara në shkresën nr. 678/4, datë 24.06.2024, duke u bazuar në aktet ligjore dhe nën ligjore mbi të cilat funksionon

⁷ Referuar Prokurës së Posaçme nr. repertori: 1392, nr. koleksioni: 1174, datë 21.05.2024, të noterit A.Gj.S.

AAPSK, vërejmë se kundërshtimet dhe pretendimet e palës ankuese janë kryesisht të bazuara në konstatime dhe në deklarime të personave të tretë, të paprovuara dhe pa faktet dhe evidencat e duhura, të cilat do na jepnin mundësinë t'i shqyrtonim.

Në lidhje me pretendimet e saj për shkelje të natyrës administrative dhe ligjore, inkurajojmë palën ankimuese të sjellë fakte dhe prova, duke bërë të mundur ndërmarrjen e proceseve të hetimit administrativ dhe pse jo edhe penal.

Për çdo pretendim të ankueses për veprime diskriminuese mbetemi të hapur dhe bashkëpunues për çdo fakt dhe provë që e provon atë dhe shprehim gatishmërinë për marrjen e masave përkatëse korrigjuese”.

Me shkresën nr. 6011/4, datë 05.07.2024, z. B.B, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme, në mes të tjerash informuan Komisionerin se: “Ministria e Brendshme ka trajtuar në mënyrë të përsëritur dhe ka kthyer përgjigje shteruese në lidhje me kërkesat ankimore, të palës ankuese.

Kundërshtitë dhe pretendimet shtesë të sjella nga ankuesja për të cilat ju kërkonit të paraqesim parashtrimet tona, nuk kanë lidhje me kërkesat ankimore të paraqitura në Ministrinë e Brendshme dhe të trajtuara nga ana jonë.

AAPSK është krijuar në zbatim të Ligjit nr. 9284, datë 30.09.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar” dhe aktualisht funksionon në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar.

AAPSK është një institucion buxhetor, aktualisht në varësi të Ministrisë së Brendshme dhe struktura e AAPSK është miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 67, datë 13.04.2022 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”, e cila ka të përcaktuar 14 punonjës organike, ku marrëdhëniet e punës janë të rregulluara me ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe aktet në zbatim të tij.

Përveç punonjësve të sipërcituar, AAPSK ka të kontraktuar punonjës me kontratë pune në cilësinë e administratorëve dhe ndihmës administratorë, ku përfshihet dhe ankuesja.

Ankesa e parë ka ardhur në Ministrinë e Brendshme nëpërmjet “Platformës së Bashkëqeverisjes”, regjistruar me nr. 539460, nëpërmjet e-mail-it zyrtar. Përgjigja i është kthyer në të njëjtën mënyrë, nëpërmjet e-mail-it zyrtar nga “Platforma e Bashkëqeverisjes”.

Ankesa e dytë ka ardhur edhe zyrtarisht dhe kthimi i përgjigjes i është bërë në të dyja mënyrat, zyrtarisht dhe nëpërmjet e-mail-it zyrtar nga “Platforma e Bashkëqeverisjes”.

Ankuesi nëpërmjet Prokurës së Posaçme me nr. 998 Rep., nr. 182 Kol., datë 07.04.2023, ka parashtruar dy çështje që nuk kishin lidhje njëra me tjetrën, një prej të cilave është kërkuar edhe më parë nga ana e përfaqësuesit me prokurën e sipërcituar, për të cilën i është bërë me dije se

përgjigja ka qenë shteruese në juridiksionin administrativ. Duke qenë se pretendimi i dytë nuk kishte lidhje me të gjithë administratoren, si dhe në kuadër të një hetimi administrativ transparent dhe ligjor, kemi kërkuar informacion nga institucioni që pretendonte se i cenonte interesat.

AAPSK na vendosi në dispozicion aktet noteriale nëpërmjet të cilëve përfaqësuesit Av. R.I i është revokuar prokura e përfaqësimit e sipërcituar, si dhe na kanë bërë me dije se prokura ka pasur tagra të kufizuara vetëm për sa i përket përfitimit të shtesës mbi pagë për natyrë të veçantë pune.

Pavarësisht faktit që përfaqësuesi nuk kishte tagra përfaqësimi, lidhur me pretendimin e dytë “për ndalimin e presionit që ushtrohet në emër të Ministrit të Brendshëm nga drejtori i komanduar Z. I.H ndaj administratorëve, me urdhra të paligjshëm dhe emërime administratorësh, jashtë listës së administratorëve të dërguar në gjykatë”, ne e kemi inkurajuar të na sjellë fakte të mbështetura në prova.

Për sa më sipër, Ministria e Brendshme ka vepruar brenda vëllimit të tagrave dhe kompetencës që ligji i ka dhënë, pa cenuar dhe diskriminuar askënd.

Kundërshtimet dhe pretendimet e palës ankuese janë në kuadër të konstatimeve personale, të paadresuara dhe të paprovuara.

Përsa i përket pretendimeve për konsumimin e veprave penale nga ana e organeve publike, kemi inkurajuar adresimin e provave dhe kallëzimin e tyre si pranë nesh, ashtu dhe pranë organeve kompetente”.

Me e-mail-in datë 26.07.2024, përfaqësuesi i ankueses Av. R.I, në mes të tjerash ka parashtruar si më poshtë: “...ankuesja duke e konsideruar të zgjidhur marrëdhënien e punës ka njoftuar se nuk pranon asnjë detyrë tjetër në AAPSK. Pas kësaj në vijim kemi kërkuar pagesën e lejes vjetore të papaguar për vitin 2024, ku pavarësisht zgjidhjes së marrëdhënies së punës, ankuesja ka të drejtë ti paguhet leja vjetore e papaguar. Ndërkohë drejtori kërkon të vazhdojë fyerjen dhe uljen e dinjitetit të ankueses, duke u përgjigjur: nuk miratohet leja e zakonshme, duhet të paraqiteni në punë me datë 22.07.2024. Përgjigje e kthyer po me datë 22.07.2024, ora 12.45.

Ndërkohë duke qenë se ankuesja pas kësaj sjellje të drejtuesit dhe punonjësve të AAPSK për të cilët ka filluar procedimi penal, ndjehet e kërcënuar dhe nuk mund të paraqitet në punë pa u marrë masat e ndalimit të diskriminimit të vazhdueshëm, shkak për të cilin është rënduar dhe gjendja shëndetësore, kemi kthyer përgjigje:

“Përsëritet! Ju falënderoj për përgjigjen mbi kërkesën time për pagesën e lejes vjetore të paguar. Duke ju kujtuar se ju keni komunikuar miratimin e vendimit të komisionit për zgjidhje marrëdhënie pune, akoma nuk jam njoftuar për ndonjë akt revokimi të këtij vendimi, dhe nuk e kuptoj kërkimin për paraqitjen time në punë, sot me datë 22.07.2024 ora 12:56, komunikim me e-mail zyrtar. Në kushtet kur unë nuk jam njoftuar as me ndonjë urdhër administrativ apo vendim gjykatë për administrimin e ndonjë pasurie, pasi ju siç më keni komunikuar edhe me email keni

vendosur heqjen e të gjithë pasurive të mia nga administrimi, që sjell edhe zgjidhjen e marrëdhënies si administratore e pasurive. Në lidhje me sa më sipër kërkoj:

- 1. Listën e pasurive që unë si administratore kam në administrim, pasi në e-mail-et e dërguara më herët nga AAPSK, më keni komunikuar që më keni heq pasuritë nga administrimi dhe do më ngarkoni në detyrë tjetër funksionale.*
- 2. Siç edhe jua kam shprehur, unë si administratore nuk kam shprehur pëlqim për ndonjë detyrë tjetër në AAPSK, deri në njoftimin e vendimit të revokimit të vendimit të zëvendësimit si administratore e pasurive në të gjithë pasuritë në administrim, ose të vendimit për emërimin në administrim të paktën një pasurie me urdhër administrativ ose vendim të organit procedues.*

Pas kësaj drejtori akoma aludon paraqitjen në punë pa vendim të ankueses. Bashkëngjitur gjeni përgjigjen me email të drejtorit, i cili vazhdon me lojën, je pushuar, nuk je pushuar.

Mbi këtë përgjigje po me email ankuesja ka kthyer përgjigjen: “Ju lutem më njoftoni urdhrin për emërimin/riemërimin tim për cilën pasuri jam ngarkuar të administroj sa parashtroni, që të paraqitem në punë, duke ju kujtuar që unë pasi më keni hequr të gjithë pasuritë e kam konsideruar dhe e konsideroj të zgjidhur marrëdhënien e punës. Siç ju kam komunikuar, nuk kam dhënë pëlqimin për detyrë tjetër, dhe duhet të rikthehem në punë me urdhër tuajin për rikthim në punë me të paktën një pasuri në Administrim. Në pritje të urdhrit tuaj për tu rikthyer në punë në pozicionin Administrator pasurie”.

Me e-mail-in datë 29.07.2024, përfaqësuesi i ankueses Av. R.I, ka parashtruar si më poshtë: “Në pritje të përgjigjes suaj për t’ju drejtuar gjykatës me padi për zgjidhjen e marrëdhënies së punës: - nga ana e Kryeadmistratorit z. I.H, znj. B.I është njoftuar për një takim në kuadrin e nenit 144 të Kodit të Punës, ku nuk bëhet as e qartë arsyeja e takimit. Z. I.H mesa duket kërkon ta konsiderojë këtë njoftim për zbatimin e procedurës për zgjidhje të marrëdhënieve të punës. Në fakt marrëdhënien e punës e kam bërë të qartë, që unë e kam konsideruar të zgjidhur, përderisa u zëvendësova në të gjithë shoqëritë që kam qenë emëruar admnistratore me z. Gj.Xh.

Në konsideratë të një vendimmarrje tuajën sa më të shpejtë, të drejtë dhe ligjore për të vënë në vend dinjitetin e cënuar të ankueses, po ju informoj me shkresën bashkalidhur të AAPSK.

Shënim: Z. I.H po mundohet të bëjë sa më shumë shkresa fiktive pasi vendi i Kryeadmniatratorit është shpallur vend vakant në DAP dhe ai do të bëjë çdo procedurë fiktive pa ardhur drejtori i ri.

Bashkangjitur gjeni shkresën e AAPSK për njoftim Znj. B.I dhe fragmentin e shkesës që AAPSK ka pranuar se ka miratuar propozimin e komisionit (për të cilin kemi kërkuar përjashtim anëtarësh dhe kryeadministratori nuk ka marë vendim), për zgjidhjen e marrëdhënies së punës”.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 678/7, datë*

31.07.2024 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 14.08.2024, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces.

Seanca u zhvillua me praninë e palëve në proces: ankuesja znj. B.I dhe përfaqësuesi i saj z. R.I dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, znj. E.H dhe përfaqësuesve me autorizimin nr. 6011/7, datë 12.08.2024, të Ministrisë së Brendshme, z. I.H, z. E.R dhe znj. K.L.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, subjekti ankues i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor dhe me e-mail me KMD-në, dorëzoi parashtrime me shkrim, si dhe në mes të tjerash deklaroi se: *“Ankuesja është diskriminuar vazhdimisht në agjenci nga Znj. E.H, e cila nuk e pranonte faktin që znj. B.I ka shami dhe bën karrierë duke pasur shami dhe është myslimane, gjë të cilën e ka shprehur vazhdimisht në korridoret e agjencisë, por nuk ka gjetur mbështetjen e drejtorëve të mëparshëm të agjencisë. Lidhur me këtë znj. B.I ka vajtur në zyrën e titullarit (I.H) dhe është ankuar dhe më ka thënë që ta tolerojmë se znj. E.H ka moshë dhe nuk do të përsëritet. Me e-mail-in datë 28.02.2024, kam kërkuar përjashtimin e znj. E.H nga komisioni.*

Z. I.H ndryshe nga sa ka parashtruar me shkrim, e ka njohur ankuesen, përpara se të fillonte punë në agjenci, si anëtare e Komisionit Ndërinstitucional të Antikorrupsionit, i cili ka përfaqësuar Ministrinë e Brendshme, ndërsa ankuesja ka përfaqësuar agjencinë. Kemi dëshmitar z. S.Sh, që z. I.H i ka thënë z. A.K, që të mos shkojë znj. B.I me shami në komisionin e Ministrisë së Brendshme, se na ul figurën.

Lidhur me procedurën për marrëdhëniet e punës, kemi marrë dijeni për njoftimin për vijimin e marrëdhënieve të punës, por jo për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës. Ne ja kemi nisur vetë email-in që nuk vimë më në punë. Që kur kemi sjellë ankesën në KMD, kemi thënë se ne nuk vimë që të diskriminohemi më tek agjencia”.

Gjatë seancës dëgjimore z. I.H i qëndroi të njëjtave parashtrime të bëra të njohura gjatë komunikimit shkresor dhe në mes të tjerash deklaroi se: *“Z. B.B është i pamundur për të ardhur sot dhe ka autorizuar përfaqësuesit e agjencisë. Pamundësia lidhet jo vetëm se ka lëvizur nga detyra si Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme, por dhe nga pamundësia fizike.*

Për ironi të faktit, sot të gjithë personat kundër të cilëve është bërë ankesa, janë mysliman, çka do të thotë se bie motivi, shkaku edhe fakti për të diskriminuar një myslimane në një institucion shtetëror. E theksoj se të katërt jemi mysliman, që do të thotë se vlerat e pretenduara nga znj. B.I, janë vlerat tona të besimit. Normat dhe praktikat e pretenduara nga znj. B.I, janë normat e familjeve tona dhe tonat individuale dhe unë e pohoj se nuk ka asnjë motiv, fakt të diskriminohet për shkak të gjinisë, fesë, veshjes, etj. Përveç dokumenteve të dorëzuara më përpara, po dorëzojmë dhe dy dokumente shtesë: Kallëzim penal datë 31.05.2024, të bërë në AAPSK, kundër znj. B.I, për

shpërdorim detyre dhe vepra të dyshuara penale dhe praktikën e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, për shumë arsye, por dhe për arsyen e fundit, atë të braktisjes së detyrës.

Ka pasur një ankesë për konflikt interesi, në kohën e ngritjes së grupit të punës, në muajin shkurt 2024, kur ngritëm një grup kontrolli për 10 nga 60 pasuritë që administroheshin nga ankuesja. Për informacion unë jam komanduar në detyrë në datë 12.02.2024, deri në përfundim të procedurës së përzgjedhjes së drejtorit të agjencisë.

Nga stafi i agjencisë më erdhi në dijeni se kemi problem me disa pasuri të marra në dorëzim. Ka pasur një ankesë nga znj. B.I, që më hiq znj. E.H nga grupi i kontrollit se kam konflikt interesi. Kam thirrur dy punonjësit dhe z. M.H dhe i kam thënë të gjejnë dy punonjës të tjerë dhe më thanë se nuk kemi punonjës të tjerë sepse ka mungesa në personel (4 punonjës). Agjencia ka 14 punonjës si staf i brendshëm dhe 14 administratorë që janë të punësuar me kontratë pune dhe për këtë arsye nuk kishim punonjës të tjerë kompetentë për të kontrolluar pasuri problematike, të identifikuar nga KLSH dhe nga kontrollet fizike të pasurive dhe prandaj i lashë në komision, i kam pyetur nëse kanë konflikt interesi me znj. B.I, më thanë jo dhe plotësuan deklaratën e konfliktit të interesit.

Më është kërkuar largimi i z. M.H dhe znj. E.H, por administrativisht është eprori direkt (M.H) dhe është një funksion kyq, nëse ka konflikt interesi ose duhet të ikin këta të dy, për gjëra më të mëdha dhe jo për një inspektim të caktuar, ose duhet të largohet ankuesja nëse ka arsye sa për të mos punuar me ta, por nuk kam pasur mundësi të përjashtoj nga funksionet e tyre institucionale dhe pozicioneve të punës.

Deri ditën e hartimit të relacionit/raportit datë 02.05.2024, nga ana e znj. B.I nuk kam asnjë ankesë, kërkesë, as verbale as me email për ngacmime seksuale, për diferencime apo keqtrajtim. Ankesat e znj. B.I, me email, etj, lidhur me pretendimet ndaj meje, filluan pasi u largua nga agjencia, të cilat mu bënë të ditura edhe nga raporti i z. Gj.Xh.

Në datë 07.05.2024 kam marrë në shqyrtim raportin e komisionit për 10 pasuritë përkatëse dhe kam bërë shënimet përkatëse: 1. Të bëhet urdhri i administratorit për dorëzimin e menjëhershëm të këtyre pasurive. 2. Të fillojë procedura për shkëputjen e marrëdhënieve të punës. 3. Të verifikohet implikimi i nivelit të shpërdorimit të detyrës dhe nëse gjykohet të bëhet procedim penal.

Këto detyra me kalimin e kohës janë ezauruar, si detyra të administratorit për stafin e agjencisë. Kam lënë një datë të diskutimit të marrëdhënieve të punës dhe mbaj mend që me datë 07-08.05.2024, sa kam bërë këtë shënim, znj. B.I ka ikur nga ambientet e agjencisë dhe për dy muaj e gjysëm me raport mjekësor dhe pasi u ndërhy tek komisionet dhe u kërkuar mënyra e dhënies së raporteve, nuk u mor më raport mjekësor dhe nuk u paraqit në punë.

Lidhur me njohjen time me znj. B.I në komisionet e ndryshme: Ju bëj me dije se kam qenë Drejtor i Përgjithshëm për Sigurinë Publike dhe Krimin e Organizuar dhe udhëheq pesë strategji ku Ministria e Brendshme është koordinatorë. Në këto procese koordinoj dhe menaxhoj me dhjetëra grupe pune ndërinstitutionale, me përbërjen e mbi 20 institucioneve sipas strategjive dhe kam

bindjen dhe pohoj se me znj. B.I jemi shkëmbyer në këto grupe pune ndërinstitucionalë, por nuk shkoj në njohje personale apo në marrëdhënie më të detajuara me znj. B.I, sepse është një nga tridhjetë personat e tjerë, por nuk ka afektuar marrëdhëniet e mia të ardhshme në detyrën e drejtorit të komanduar të agjencisë.

Lidhur me pohimin se nga z. A.K ka marrë një pososi nga unë që znj. B.I të mos thirret në grupin e punës: Sugjeroj që të merret deponimi i ish kryeadministratorit dhe nëse e pohon, realisht jam i surprizuar dhe i keqardhur, por nuk është diskutuar.

Lidhur me raportimin dhe ngacmimin seksual nga ndihmës administratori: Nga raportet pas këtij shërbimi dhe nga znj. B.I më ka thënë se shërbimi u krye me sukses dhe pasuria u mor në dorëzim. Është e vërtetë se ka shkuar vetëm me ndihmësin dhe ai ka përdorur makinën e tij, por dhe po të kem kërkesë sot, unë nuk mund të caktoj dhe të siguroj shoqërues, në 70 pasuritë që ka pasur në administrim, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ndaj znj. B.I ka pasur masa disiplinore, vërejtje, tërheqje vëmendje, paralajmërim për pushim nga puna të rekomanduar nga KLSH, por që nuk ishin ezauruar nga kryeadministratori, sepse u largua nga detyra. Plotësimi i rekomandimeve të raportit të KLSH, ka qenë pikë e komisioneve sepse është detyrim, por dhe aspekte të tjera shtesë që identifikohen në rutinën e përditshme të administrimit.

Kemi procedura në proces të diskutimit për vijimin e marrëdhënieve të punës dhe me punonjës të tjerë”.

Gjatë seancës dëgjimore znj. E.H i qëndroi të njëjtave parashtrime të bëra të njohura gjatë komunikimit shkresor dhe në mes të tjerash deklaroi se: “Z. R.I duke pasur një prokurë për përfaqësim ligjor në gjykatë për pagesat e administratorëve, ka shkruar në faqet zyrtare të disa institucioneve, duke më rritur në pozicion, duke më bërë shefe finance, sikur unë jap shtesat e pagës, nuk u rris pagën administratorëve, ndërkohë që unë jam specialiste e kategorisë IV-A, që e dini se çfarë funksioni ka. Pas kësaj, në datë 20.11.2023, z. Adrian Koni (ish kryeadministratori) na ndan të gjithë administratën për administrimin fizik të pasurive në të gjithë territorin. Mua më bien pasuritë në administrim të znj. B.I, të cilët KLSH i kishte lënë me të zezë dhe ka dëm ekonomik. Unë kam mbajtur procesverbal në vend, në të cilët ka firmosur vetë znj. B.I, përfaqësuesi tjetër i komisionit dhe unë. Duke ditur natyrën time të punës znj. B.I, pretendon se ka konflikt interesi, se ky komision do të shkonte po te këto pasuri, të cilat ishin me shkelje nga KLSH dhe nga inventarizimi fizik, nuk është zbatuar vendimi i gjykatës. Znj. B.I duhet ta vërtetojë me fakte që unë e kam ofenduar, sepse mysliman jemi të gjithë”.

Në vijim, subjekti ankues me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 678/9, datë 16.08.2024, ka dërguar parashtrime shtesë dhe prova, lidhur me detyrat e lëna gjatë seancës dëgjimore dhe në mes të tjerash informoi se: “Në lidhje me sa u deklarua në seancën dëgjimore për ankuesen Znj. B.I, duke marrë parasysh dhe detyrat e lëna nga Komisioneri, parashtrojmë si më poshtë:

1. Siç e patë edhe vetë, ankuesja Znj. B.I, është shumë e rënduar psikologjikisht nga pala e akuzuar për diskriminim, saqë nuk e mbante dot veten pa komunikuar me palën tjetër, për shkak të ofendimeve që vazhdonin nga ana e znj. E.H edhe në praninë tuaj, gjë që u bë shkak për ndërprerjen e seancës me të drejtë nga ana juaj.
2. U pretendua se ankuesja e ka nisur ankesën pranë jush pasi është njohur me raport kontrollin e bërë nga ana e komisionit të ngritur për kontrollin e pasurive të AAPSK (këtu e më poshtë komisioni fiktiv) dhe që ka kontrolluar vetëm ankuesen Znj. B.I. (Në fakt është krejt e kundërta, ankesa është paraqitur me postë me datë 29.04.2024, ndërsa raporti mban datën 02.05.2024).

Një pretendim i tillë i palës tjetër, është i pabazuar, në referim të dëftesës postare që mban ankimi i ankueses.

3. Kemi sjellë një observacion të ankueses drejtuar kryeadministratorit, protokolluar pranë agjencisë me nr. 717/7, datë 28.03.2023, ku provohet se i është bërë e qartë në observacion kryeadministratorit, emaili i dërguar që me datë 28.02.2024, email që e gjeni bashkangjitur edhe këtij parashtrimi.

Në observacion faqe 1, paragrafi i parë citohet: “..... referuar emailit zyrtar ku kam relatuar në email ndër të tjera kam kërkuar si më poshtë ju rikujtoj që të merrni masa administrative për fyerjet që janë bërë ndaj meje nga anëtarja e komisionit Znj. E.H, shkak për të cilin ajo është në konflikt interesi që përbën shkak për skualifikimin nga komisioni në rastin tim.....”.

Në observacion kryeadministratorit i citohen edhe baza ligjore, nenet 31 e 32 të Kodit të Procedurës Administrative, ku në faqen 2, paragrafi 5 i observacionit ankuesja ka cituar: “.... sa më sipër pjesëmarrja e grupit të kontrollit pa një vendimmarrje nga titullari i institucionit sjell paligjshmëri të këtyre akt verifikimeve duke i falsifikuar.....”. Referojuni akt konstatimit për akt verifikimet e bëra me qëllim të rremë nga ky grup kontrolli fiktiv në konflikt interesi dhe duke e diskriminuar ankuesen. Në faqe 6, paragrafi 4 të observacionit citohet: “... me çfarë të drejte dhe ku e gjen guximin Znj. E.H të fyejë administratorin e pasurisë në prani të vartësve të saj”.

Po në faqe 6, paragrafi 9 i observacionit citohet: “.... z. M.H dhe Znj. E.H janë në konflikt interesi me mua për shkakun që bashkëshorti im ka kryer ankesën me prokurë të dhënë nga të gjithë administratorët për përfitimin me pa të drejtë të shtesës së pagës që u takojnë administratorëve”. Bashkëngjitur gjeni prokurën, ankesën e bërë, përgjigjen e institucionit tek bashkëqeverisja, vendimin për mosfillim procedimi penal.

Në faqen e fundit të observacionit citohet që në protokoll bashkëlidhur observacionit nga ankuesja, është dërguar dhe emaili i datës 28.02.2024, ora 11:59 PM (7 faqe). Këtë email do e gjeni edhe bashkëlidhur ankesës që ju kemi dërguar me postë në formularin datë 29.04.2024.

4. Pasi jemi njoftuar në datën e seancës dëgjimore pranë jush, se kryeadministratori (pavarësisht korrespondencës me email, ku i komunikon paditëses zgjidhjen e

marrëdhënies së punës si administratore pasurie) me shkresën nr. 1977/1, datë 04.06.2024, drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, (në procedurën e filluar mbi ankesën për diskriminim të paditëses në marrëdhëniet e punës, të datës 02.05.2024), ka pranuar miratimin e propozimit të komisionit, (për të cilin kemi kërkuar përjashtimin e anëtarëve të komisionit, Z. M.H dhe Znj. E.H, për arsye të konfliktit të interesit dhe diskriminimit) për zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënies së punës së paditëses Znj. B.I, kemi paraqitur me shkrim në seancë, parashtrime ku veç sa kemi kërkuar në ankesë, kërkojmë edhe rikthimin në vendin e mëparshëm të punës së ankueses Znj. B.I, paraqesim këto parashtrime shtesë dhe provat sipas detyrave të lëna nga Komisioneri.

Sa më sipër, përveç sa është pohuar edhe vet nga kryeadministratori Z. I.H, për personalitetin e ankueses, provohet trajtimi i veçantë i ankueses (diskriminimi), nga të gjithë punonjësit e tjerë, gjë që përbën shkak për diskriminim, për shkak të trajtuara në ankesë.

Sa më sipër kërkoj pranimin e ankesës sipas objektit, duke konstatuar diskriminimin e ankueses në marrëdhëniet e punës dhe detyrimin e AAPSK të rikthejë ankuesen në vendin e mëparshëm të punës”.

Në vijim, AAPSK me shkresën nr. 1977/6, datë 16.08.2024, ka dërguar informacion shtesë dhe prova, lidhur me detyrat e lëna gjatë seancës dëgjimore dhe në mes të tjerash informoi se: “Znj. B.I gjatë seancës së zhvilluar ka pretenduar që grupi i kontrollit ishte ngritur vetëm për të kontrolluar pasuritë e administruara prej saj. Në lidhje me këtë pretendim, ashtu siç është deklaruar edhe më parë, vlen të theksohet se kontrolli është ushtruar vetëm në ato pasuri problematike, të administruara nga znj. B.I, të identifikuar edhe nga ekipi i kontrollit të KLSH. Ju bëjmë me dije se znj. B.I ka patur në administrim gjatë kohës që ushtronte detyrën, më shumë se 60 pasuri, por objekt kontrolli kanë qenë vetëm pasuritë problematike, me detyra të lëna nga KLSH në auditimin e fundit, që përbën vetëm 5% të pasurive të administruara nga znj. B.I, fakt që vërtetohet edhe nga raporti i sjellë nga grupi i kontrollit me nr. 717/1, datë 02.05.2024.

Ju vëmë në dijeni që ushtrimi i kontroleve në pasuritë që administrohen nga administratorët është veprimtari rutinë që planifikohet nga administrata e AAPSK-së, për përmbushjen e përgjegjësi të saj institucionale, bazuar në parimet e mirëadministrimit, efektivitetit, efijensës, ekonomikitetit, transparencës, të ligjshmërisë si dhe shmangies, shpërdorimit e keqpërdorimit të pasurive që ka në administrim. Këto kontrole, ushtrohen për mbështetjen e administratorëve dhe për ndihmën ndaj tyre, për rritjen e efektivitetit në koordinim me institucione të tjera nga ana e tyre, për vlerësimin e tyre si dhe për qëllime e objektiva të tjera të AAPSK-së.

Kontrolli i pasurive për vitin 2024, inventarizimi i tyre dhe magazinimi i pasurive, është ndërmarrë ndaj të gjithë administratorëve dhe këto dokumente kryesorë të agjencisë kanë planifikuar detyrime për të gjithë administratorët. Po kështu, çdo komunikim i drejtuesve të agjencisë dhe i çdo sektori në agjenci, në lidhje me kontrollin e pasurive është njoftuar në mënyrë publike, zyrtarisht, tek të gjithë administratorët, duke hedhur poshtë çdo pretendim për diferencim mbi

baza fetare, gjinore, etj (bashkëlidhur disa urdhra të ngritur për kontrollet e pasurive që administrohen nga administratorë të tjerë dhe relacionet epërgatitura nga grupet e kontrollit).

Bazuar në faktet dhe rrethanat dhe dëmin e shkaktuar buxhetit të shtetit dhe AAPSK-së, në administrimin e 10 pasurive të inspektuara gjatë muajit shkurt 2024, institucioni ynë ka depozituar kallëzimin penal për shpërdorim detyre për znj. B.I (bashkëlidhur kallëzimi penal, nr. 2137, datë 31.05.2024).

Theksojmë se gjatë procesit të marrjes në dorëzim të pasurive që administroheshin prej znj. B.I dhe që kaluan tek administratori z. Gj.Xh, janë inspektuar dhe marrë në dorëzim edhe më shumë se 40 pasuri të tjera. Abuzimet dhe shpërdorimi i detyrës nga znj. B.I me këto pasuri, mospërmbushja e përgjegjësiave nga ana e saj në lidhje me administrimin e tyre janë të shumta dhe me një dëm ekonomik të konsiderueshëm. Po përmendim vetëm disa nga abuzimet e identifikuar, që përbëjnë edhe elementë të mundshëm të veprës penale, siç janë: pasuri që administrohen nga subjektet me kontrata të përfunduara që nga viti 2022 dhe të parinovuara me tarifat e reja, në bazë të VKM-së përkatëse; pasuri të paadministruara, të pa dhëna me qira; shoqëri tregtare administrimi i të cilave është lënë në autoritetin e vetë subjekteve kriminale nga znj. B.I; mbi 16 pasuri që nuk janë marrë në dorëzim dhe nuk është bërë asnjë përpjekje bashkëpunimi me institucionin e prokurorisë dhe të policisë së shtetit. Të gjitha këto shkelje, AAPSK, do t'ia bashkëngjisë kallëzimit penal të sipërpërmendur dhe do i dërgojë në prokurori.

Përsa i përket pretendimeve të znj. B.I për ngacmime seksuale nga ndihmësi i saj z. Gj.Xh, ju bëjmë me dije që vetë zonja ka bërë kërkesë për shërbim bashkë me ndihmësin e saj dhe në asnjë moment nuk është shprehur që kërkon shoqërues të tjerë. Në përfundim të shërbimit është dorëzuar një informacion në lidhje me ekzekutimin e shërbimit nga ana e znj. B.I dhe nuk është ngritur asnjë pretendim që gjatë kohës së kryerjes së shërbimit ka pasur shqetësime nga ana e z. Gj.Xh (bashkangjitur praktika për kryerjen e shërbimeve).

Siç u diskutua dhe u informua në seancën dëgjimore, AAPSK ka ndërprerë marrëdhënien e punës znj. B.I, me datë 02.08.2024. Një vendim i tillë ka ardhur pas shqyrtimit të performancës së saj në administrimin e pasurive dhe kryesisht bazuar në rezultatet dhe rekomandimet e KLSH,-tetor 2023, në rezultatet dhe rekomandimet e ekipit të kontrollit me nr. 717, datë 02.05.2024 dhe në rezultatet dhe gjetjet nga relacioni/procesverbali i marrjes në dorëzim të pasurive të saj, nga ana e z. Gj.Xh. Një tjetër arsye ligjore dhe e pashmangshme për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, është mosparaqitja pa arsye në punë dhe braktisja e punës për më shumë se 7 ditë pune, nga ana e ankueses. Znj. B.I nuk është paraqitur në punë dhe nuk ka njoftuar asnjë arsye që nga data 22.07.2024. Vetëm pas këtyre rrethanave është filluar ecuria e shkëputjes së marrëdhënieve të punës nga ana e Kryeadministratorit të AAPSK-së. Ju informojmë se çdo procedurë për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës është bërë konform përcaktimeve ligjore në Kodin e Punës, rregulloren e AAPSK dhe në përputhje me detyrimet dhe të drejtat në kontratën e saj të punës (bashkëlidhur praktika e shkëputjes së marrëdhënie të punës, njoftimi i saj për seancë dëgjimore,

proces verbali i mbajtur nga komisioni i ngritur për këtë qëllim dhe urdhri i Kryeadministratorit me motivacionin përkatës).

AAPSK ka në prioritet dhe në objektivat e saj, mirëadministrimin e pasurive të marra në dorëzim. Për këtë ka iniciuar një numër të madh programesh dhe aktiviteteve për të përmirësuar performancën e agjencisë dhe për të përmbushur përgjegjësitë e saj institucionale. Në këtë proces, ka identifikuar edhe mangësi dhe shkelje nga administratorë të ndryshëm, mospërgjegjësi të tempit të agjencisë, neglizhime dhe mospërmbushje të përgjegjësisë nga ana e tyre. Po ju bashkëlidhim dy praktika të filluara tashmë për dy administratorë znj. E.S dhe z. E.B, përfundimet e të cilave do të rezultojë pas seancave dëgjimore”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre*”.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ndryshuar, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: “*Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij*”.

Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 12/1/c, ku përcaktohet se: “*Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij*

ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ... c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.”, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, bazuar në gjini, bindje fetare, pamjen e jashtme dhe çdo shkak tjetër, duke përfshirë këtu pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.

Bazuar në pikën 5, germa “c”, të nenit 9, të Kodit të Punës, parashikohet se: *“Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me:..c) kushtet e punës dhe punësimit, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën”.*

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesi është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke dalluar, përjashtuar apo kufizuar ankuesin në të drejtën e tij për punësim, duke përfshirë këtu edhe momentin e përfundimit e marrëdhënieve të punës;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesja, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ankuesja i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e saj për punësim dhe më konkretisht në lidhje me zgjidhjen e kontratës së punës.

- *Lidhur me kallëzimet penale të bëra nga palët, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.*

Lidhur me kallëzimin penal të bërë pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe ankesat e bëra pranë bashkëqeverisjes, nga ana e Av. R.I, (bashkëshorti i ankuses) si përfaqësues i 11 administratorëve të pasurive, me prokurën e posaçme datë 07.04.2023, lidhur me pagën dhe deklarinimin në sistem jo si administratorë pasurie por si administrator të dhënash dhe përfitimin e pagesës për natyrë të veçantë pune.

Pretendimet sa më sipër, Av. R.I si përfaqësues i administratorëve të pasurive të AAPSK, i ka bërë pjesë të kallëzimit penal nr. 7627, të vitit 2024, (kërkesë ankimore nr. K503, datë 10.05.2024 e bërë pranë PPKKO, e përcjellë për kompetencë lëndore pranë Prokurorisë së Tiranës me shkresën nr. K503/1, datë 13.05.2024) kallëzim për të cilin Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me shkresën datë 7627, datë 31.07.2024, ka vendosur mosfillimin e procedimit të kallëzimit penal.

Gjithashtu me e-mail-in datë 05.12.2023, Zyra e bashkëqeverisjes i ka kthyer përgjigje kërkesës me nr. 538875, të z. I, si përfaqësues i administratorëve të AASPK, lidhur me deklarimin si administratorë pasurie në sistemin HRMIS, si dhe pagesën për shtesë mbi pagë për natyrë të veçantë pune, në referim të VKM nr. 187, datë 08.09.2017 *“Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”*.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar, rezulton se znj. B.I në datë 27.02.2024, ka dorëzuar Kallëzim Penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, kundër znj. E.H në cilësinë e financieres të AAPSK, me objekt: Fillimin e procedimit penal ndaj të kallëzuarës, Znj. E.H, për veprat penale të *“Shpërdorimit të detyrës”* e kryer në bashkëpunim, parashikuar si vepër penale nga nenet 248 e 25 të Kodit Penal dhe *“Fyerjes dhe shpifjes”*, parashikuar si vepër penale nga nenet 119 e 120 të Kodit Penal, të ndryshuar. Në këtë kallëzim ankuesja ka deklaruar se: *“E kallëzuara Znj. E.H duke qenë përpara konstatimeve të bëra nga ana ime si më sipër por edhe nga shkaqe të marrëdhënieve personale që prej një viti vazhdimisht më fyen dhe ofendon duke shpifur fjalë nga më të rëndat për dinjitetin tim”*.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar, rezulton se znj. B.I në datë 09.05.2024, ka dorëzuar Kallëzim Penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, kundër z. I.H në cilësinë e Kryeadministratorit të komanduar të AAPSK dhe z. M.H në cilësinë e administratorit të sektorit ekonomiko-financiar pranë AAPSK, me objekt: Fillimin e procedimit penal ndaj të kallëzuarve, Z. I.H dhe Z. M.H, për veprat penale të *“Shpërdorimit të detyrës”* e kryer në bashkëpunim, parashikuar si vepër penale nga nenet 248 e 25 të Kodit Penal. Pjesë e këtij kallëzimi ishin dhe veprimet e kryera nga z. I.H dhe z. M.H, lidhur me marrëdhëniet e punës dhe detyrat e ngarkuara për ndihmës administratorin z. Gj.Xh.

Në datë 10.06.2024, znj. B.I ka dorëzuar shtesë Kallëzimi Penal, kundër z. I.H dhe z. M.H, edhe për veprat penale të: *“Fallsifikimit të dokumenteve nga personi që ka për detyrë të lëshojë aktin”* e kryer në bashkëpunim, parashikuar si vepër penale nga nenet 186/3 e 25 të Kodit Penal. Në këtë shtesë kallëzimi penal, ankuesja ka parashtuar të njëjtat fakte dhe prova të bëra të ditura Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 678/3, datë 10.06.2024.

Rezulton se me shkresën nr. 2137, datë 31.05.2024, AAPSK ka dorëzuar Kallëzim Penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, kundër znj. B.I në cilësinë e Administratorit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, me objekt: Kallëzim i veprës penale *“Shpërdorimi i detyrës”*, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Për sa më sipër, Komisioneri vëren se disa pretendime të bëra nga palët pranë Komisionerit, janë pjesë dhe e kallëzimeve penale të bëra nga palët pranë Prokurorisë. Komisioneri vlerëson se marrja në shqyrtim e çështjeve që janë kompetencë e organeve si prokuroria e gjykata, bazuar në pretendime të tilla që lidhen me kundravajtje apo vepra penale të parashikuara në legjislacionin

penal të Republikës së Shqipërisë⁸, nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së, e për pasojë nuk do ti nënshtrohen procedurave për shqyrtimin e tyre, pasi është Prokuroria organi kompetent që ushtron ndjekjen penale⁹.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se:

Referuar Librezës së Punës të znj. B.I, rezulton se ka filluar punë pranë Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara në datë 13.06.2016, në pozicionin si “Administratore Pasurie”. Në datë 02.10.2023, është lidhur Kontrata Individuale e Punës me kohëzgjatje të pacaktuar, me nr. 3213, datë 02.10.2023.

Me shkresën nr. 1771, datë 10.05.2024, AAPSK në zbatim të raportit përfundimtar dhe rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka njoftuar znj. B.I për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra”.

Referuar raporteve mjekësore të lëshuar nga Qendra Shëndetësore Shkozë, për periudhën nga data 08.05.2024 deri me datë 20.07.2024, znj. B.I ka qenë me raport mjekësor për paafësi në punë dhe pas kësaj date ajo nuk është paraqitur në punë.

Me shkresën nr. 3950, datë 29.07.2024, të AAPSK, znj. B.I është njoftuar për zhvillimin e mbledhjes në datë 01.08.2024, lidhur me vijimin e marrëdhënieve të punës. Në datë 01.08.2024, znj. B.I nuk është paraqitur në takim.

Me Urdhrin nr. 459, datë 02.08.2024 “Për zgjidhje të menjëhershme të kontratës individuale të punës”, të AAPSK, është urdhëruar zgjidhja e menjëhershme e kontratës së punës me znj. B.I, pasi ka kryer shkelje: a) mospërbushja e detyrave; b) moszbatimi haptazi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; c) braktisja e punës për më shumë se 7 ditë.

- *Lidhur me pretendimin e subjektit ankues kundër z. B.B, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme.*

Komisioneri vlerëson se, marrëdhëniet kontraktuale ndërmjet punëdhënësit/Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara dhe punëmarrësit/ankueses, i nënshtrohen përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore që normojnë këtë marrëdhënie. Në këtë kontekst, lidhur me pretendimin e ankueses se veprimet diskriminuese janë ndërmarrë nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme, Komisioneri vlerëson si më poshtë:

Në nenin 9 të Ligjit 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, përcaktohet se: “1. Agjencia drejtohet dhe përfaqësohet nga kryeadministratori, i cili raporton ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike. Marrëdhëniet e punës së kryeadministratorit

⁸ Shpërdorimi i detyrës, falsifikimi ose përdorimi i dokumenteve të falsifikuara nga zyrtarë shtetërorë.

⁹ Neni 148, i Kushtetutës së Shqipërisë shpreh se: “Prokuroria ushtron ndjekjen penale....”

rregullohen nga legjislacioni në fuqi për nëpunësin civil”; 2. Kryeadministratori ka këto kompetenca dhe përgjegjësi: a) drejton dhe organizon veprimtarinë e Agjencisë; d) cakton ose kontraktin administratorët e pasurisë së sekuestruar me vendim gjykatë ose urdhër administrativ”, ndërsa në nenin 11/1, parashikohet se: “Administratori i pasurisë së sekuestruar caktohet nga kryeadministratori i Agjencisë”.

Në nenin 15 dhe 16 të ligjit 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, përcakton detyrat e Sekretarit të Përgjithshëm, në të cilat parashikohet se:

Neni 15.

1. Sekretari i përgjithshëm është nëpunësi më i lartë civil në një ministri. Ai i raporton dhe jep llogari drejtpërdrejt te ministri.
2. Sekretari i përgjithshëm ka këto përgjegjësi kryesore:
 - a. të mbështesë ministrin;
 - b. të sigurojë zbatimin dhe kontrollin e zbatimit të politikave;
 - c. të sigurojë drejtimin, mbikëqyrjen dhe koordinimin e ministrisë;
 - ç. të sigurojë bashkëpunimin me ministrinë e tjera dhe institucionet e organet e pavarura;
 - d. të sigurojë administrim efektiv dhe eficient të burimeve financiare, materiale dhe njerëzore të sistemit ministrior, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - dh. çdo përgjegjësi tjetër që i caktohet nga legjislacioni.
3. Sekretari i përgjithshëm zëvendësohet, në rast mungese apo paaftësie afatshkurtër, nga njëri prej drejtorëve të përgjithshëm të ministrisë.

Neni 16.

Strukturat përgjegjëse për funksionet horizontale

1. Menaxhimi i burimeve njerëzore, çështjet juridike, mirëmbajtja dhe shërbimet e tjera mbështetëse kryhen të gjitha së bashku nga një strukturë administrative, në vijim “shërbimet e brendshme mbështetëse”, që i raporton drejtpërdrejt sekretarit të përgjithshëm.
2. Funksionet e lidhura me planifikimin, zbatimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar, më poshtë “funksionet e financave”, kryhen të gjitha së bashku nga një strukturë administrative, që i raporton drejtpërdrejt sekretarit të përgjithshëm.

Në ankesën e saj, znj. B.I ka pretenduar se Sekretari i Përgjithshëm ka udhëzuar për diskriminim Kryeadministratorin e komanduar të AAPSK-së, mes të cilëve ka marrëdhënie hierarkike, (pasi është dhe Drejtor i Politikave në Ministrinë e Brendshme), duke i kërkuar largimin nga puna të znj. B.I.

Ankuesja megjithëse ka ngritur pretendim kundrejt Sekretarit të Përgjithshëm, nuk vuri në dispozicion të Komisionerit prova të drejtpërdrejta apo të tërthorta të urdhrit apo udhëzimit të dhënë nga z. B.B në drejtim të ankueses dhe lidhjes shkakësore ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm

dhe shkaqeve të mbrojtura, apo prova që z. B.B të kishte shtyrë/urdhëruar, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo në formën e udhëzimit për diskriminim, Kryeadministratorin apo ndonjë punonjës tjetër për të ndërmarrë veprime të pafavorshme kundrejt ankueses. Z. B.B në funksionin si Sekretar i Përgjithshëm, bazuar në detyrat dhe funksionet e cituara më sipër ka vepruar brenda tagrave dhe funksionit të tij duke kthyer përgjigje ankueses dhe institucionit të varësisë.

Të gjitha pretendimet e znj. B.I kundrejt Sekretarit të Përgjithshëm janë të karakterit deklarativ dhe nuk mbështeten në prova konkrete. Për këtë arsye, Komisioneri vlerëson se pretendimet e ankueses kundër z. B.B, nuk mund të provohen dhe nuk do bëhen objekt shqyrtimi në vijim të trajtimit të ankesës.

- *Lidhur me pretendimin e subjektit ankues kundër z. M.H me detyrë Administrator i Sektorit të Administrimit Ekonomik-Financiar të Pasurive pranë AAPSK-së.*

Në ankesë në mes të tjerash, znj. B.I ka pretenduar se është ofenduar nga z. M.H gjatë periudhës së verifikimit të pasurive në administrim dhe se z. M.H është në konflikt interesi me të, për shkak se bashkëshorti i saj ka kryer ankesën/kallëzimin me prokurë të dhënë nga të gjithë administratorët për përfitimin me pa të drejtë të shtesës së pagës që u takojnë administratorëve.

Gjithashtu ankuesja ka pretenduar se kur ka ardhur grupi i kontrollit nga KLSH, vetëm dosjet e saj nuk janë marrë me përzgjedhje për kontroll, por janë marrë në inspektim të gjitha dosjet që ka pasur në administrim, duke u veçuar nga administratorët e tjerë, të cilëve u janë kontrolluar me përzgjedhje, duke u diskriminuar në këtë mënyrë nga z. M.H, nëpërmjet gruas së tij (B.H.Z) që është Kryeaudituese në KLSH.

Referuar Raportit përfundimtar për auditimin e ushtruar në AAPSK, të muajit shtator 2023, të hartuar nga KLSH, ndër të tjera rezulton se:

“Nga ana e KLSH është kryer auditimi në AAPSK mbi përputhshmërinë e aktivitetit për periudhën nga data 01.10.2017 deri më 31.12.2022, nga Grupi i Auditimit me përbërje: 1. E.H, Përgjegjëse Grupi; 2. K.T, Kryeauditues; 3. A.Ç, Audituese; 4. M.V, Audituese.

Auditimi u krye me bazë risku, për vlerësimin e zbatimit të procedurave ligjore në fushën e administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, vlerësimin e saktësisë së aktiviteteve dhe transaksioneve financiare, çështjeve që lidhen me organizimin dhe funksionimin e agjencisë, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, vlerësimin e saktësisë së informacioneve në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit ushtron veprimtarinë Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

2.2.2 Mbi zbatimin e procedurave të ndjekura për administrimin e aseteve të marra në dorëzim dhe mënyra e menaxhimit të tyre nga administratorët.

Në 23 vendime të audituara nga 77 të raportuara, nga shqyrtimi me zgjedhje në bazë risku i dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjeve fizike, u konstatuan disa parregullsi, veprime dhe mosveprime në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator, konkretisht si vijon:

Për sa më sipër, AAPSK ka vepruar në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator, veprime për të cilat ngarkohen me përgjegjësi:

- Administratorët e pasurive: z. A.B, z. E.R, znj. B.I, z. E.B, z. S.M, z. F.A, znj. E.A, znj. E.O;
- Kryeadministratori (A.K. periudha 01.10.2017-09.03.2021; Q.TH. periudha 09.03.2021-01.04.2022 dhe A.K. periudha 01.04.2022-31.12.2022)...

2.2.3 Mbi vendimmarrjen dhe procedurat e ndjekura nga administratorët në lidhje me dokumentacionin dhe të dhënat e regjistruara pranë QKB-së, në funksion të administrimit të drejtpërdrejtë të shoqërive tregtare.

Nga 20 shoqëritë tregtare të raportuara dhe të administruara në mënyrë të drejtpërdrejtë nga AAPSK (administratori përkatës) përgjatë periudhës 2017-2022, grupi i auditimit, me përzgjedhje, shqyrtoi Ekstraktet Historikë dhe dokumentacioni përbërës i tyre, i pasqyruar në regjistrin tregtar (elektronik), të krijuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (në vijim “QKB”) në lidhje me 10 shoqëri:

Për sa më sipër, AAPSK ka vepruar në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator, veprime për të cilat ngarkohen me përgjegjësi administratorët z. A.B, znj. B.I dhe z. F.A, të cilët kanë në administrim të drejtpërdrejtë subjektet e sipërcituara.

2.5 Mbi kontrollin fizik të pasurive në terren.

Referuar kuadrin ligjor të veprimtarisë së institucionit të AAPSK- së, referuar Rregullores nr. 1363, datë 22.04.2021 “Për organizmin e punës në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara” në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara” (AAPSK), neni 12, specialisti për kontrollin fizik dhe provat materiale ka detyrë dhe përgjegjësi të kontrolloj në terren gjendjen e pasurive të sekuestruara/konfiskuara në administrim të AAPSK. Bazuar në raportet mujore të administratorëve të pasurisë, ai inicion kontrole të autorizuara nga Kryeadministratori i AAPSK-së. Ky specialist, kryen kontrollin periodik të pasurisë së sekuestruar apo konfiskuar bashkë me administratorin e pasurisë duke asistuar dhe në miradministrimin e saj, dhe raporton mbi punën e kryer pranë përgjegjësit të sektorit dhe kryeadministratorit.

Sipas dokumentacionit të paraqitur nga Specialisti i Kontrollit fizik dhe provave materiale, mbi kontrollin, shkeljet e konstatuara dhe raportimin rezulton se janë mbajtur procesverbale si në vijim, shoqëruar me konstatimet dhe rekomandimet përkatëse: Procesverbale të Specialistit mbi kontrollin fizik të pasurive dhe provave materiale.

Citohen 17 procesverbale.

Për sa më sipër nga grupi i auditimit të KLSH-së u verifikuan në terren pasuritë si vijon:

Citohen të jenë verifikuar 12 pasuri.

Në kundërshtim me pikën 18 të nenit 14 të Rregullores së Brendshme, në lidhje me pasuritë e verifikuara në terren, nga ana e administratorëve nuk është përgatitur asnjë raport apo procesverbal periodik ku të pasqyrohen kontrollat e herëpas-hershme në objekt për të parë gjendjen fizike të pasurisë apo pagesat mujore të qirasë, faturave të energjisë dhe ujit të pijshëm. Për sa më sipër, AAPSK ka vepruar në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator, veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi administratori përkatës i pasurisë si dhe Kryeadministratori.

D. Masa disiplinore.

D.1 Për punonjësit në marrëdhënie pune.

Menjëherë dhe në vijimësi.

I. Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, gjerat “b”, “c” dhe “ç”; bazuar në nenin 58 dhe 59 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, si dhe në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Ministrit të Brendshëm, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të fillojë procedurat ligjore për dhënien e masave disiplinore si vijon:

a) “Largim nga shërbimi civil”.

I. Z. A.K., me detyrë Kryeadministrator për:

-Mospërmbushje të rëndë të detyrave, pasi në drejtimin dhe organizimin e veprimtarisë së Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara nuk ka arritur të zbatojë detyrimet dhe kompetencat ligjore, e rezultuar kjo në mangësitë e theksuara në mbikëqyrjen dhe kontrollin e veprimtarisë që kryhet për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.

II. Mbështetur në nenin 15 shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; në nenin 11, kreu IV dhe nenit 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Rregulloren e Brendshme të AAPSK (Masat Disiplinore), si dhe në kontratën individuale të punës, i rekomandojmë Kryeadministratorit të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të fillojë procedurat ligjore për dhënien e masave disiplinore si vijon:

a) “vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra”, për 5 (pesë) punonjës si më poshtë:

1. z. A.B; 2. znj. B.I; 3. z. E.B; 4. z. S.M; 5. z. E.R, me detyrë administratorë të pasurive pranë AAPSK.

b) “vërejtje me shkrim”, për 2 (dy) punonjës si më poshtë:

1. znj. E.A; 2. Znj. E.O, me detyrë administratorë të pasurive pranë AAPSK”.

Referuar dokumentacionit dhe deklarimit të bërë gjatë seancës dëgjimore nga ana e AAPSK, rezulton se agjencia ka në administrim mbi 1100 pasuri, ndërsa znj. B.I ka në administrim rreth 60 pasuri. Referuar raportit të KLSH-së, të sipërcituar rezulton se grupi i auditimit të KLSH-së ka marrë në auditim 23 vendime nga 77 të raportuara (pika 2.2.2 e raportit), të cilat janë zgjedhur në bazë risku. Bazuar në gjetjet e këtij raporti rezulton se grupi i auditimit ka gjetur shkelje për 7 administratorë pasurie, në mes të cilëve është dhe ankuesja. Në masat disiplinore, grupi i auditimit ka rekomanduar fillimin e procedurave ligjore për dhënien e masës disiplinore “vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra”, për 5 administratorë pasurie që janë gjetur me shkelje, në mes të cilëve është dhe znj. B.I.

Në shqyrtim të fakteve të parashtuara sa më sipër, Komisioneri vlerëson se grupi i auditimit të KLSH-së, nuk ka trajtuar ankuesen në mënyrë të pabarabartë krahasuar me administratorët e tjerë, lidhur me shkeljen e pretenduar nga znj. B.I, që vetëm asaj i janë marrë në inspektim të gjitha dosjet.

Në mungesë të trajtimit të pabarabartë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një veprim të pabarabartë nga ana e grupit të auditimit të KLSH-së dhe si rrjedhim dhe nga z. M.H dhe për rrjedhojë nuk provohet se nga z. M.H, janë shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Gjithashtu ankuesja megjithëse ka ngritur pretendim kundrejt z. M.H, se është ofenduar gjatë periudhës së verifikimit të pasurive në administrim, nuk vuri në dispozicion të Komisionerit prova të drejtpërdrejta apo të tërthorta të këtyre ofendimeve të bëra nga z. M.H.

Të gjitha pretendimet e znj. B.I kundrejt z. M.H janë të karakterit deklarativ dhe nuk mbështeten në prova konkrete. Për këtë arsye, Komisioneri vlerëson se pretendimet e ankueses kundër z. M.H, nuk mund të provohen dhe nuk do bëhen objekt shqyrtimi në vijim të trajtimit të ankesës.

- Lidhur me pretendimin e subjektit ankues kundër znj. E.H, me detyrë specialiste finance pranë AAPSK-së.

Ankuesja shprehet se është besimtare muslimane dhe veshja e saj është sipas këtij besimi duke mbajtur dhe shami në kokë. Ankesja pretendon se prej shumë vitesh znj. E.H ka përdorur fjalë fyese, ofenduese dhe bullizuese, të tilla si “katundare”, “hajdute me shami”, “Me një të kërcyer për vit të ri, e fitoi udhëtimin në serbi”, e shumë shprehje të tjera, për shkak të besimit fetar.

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar, rezulton se znj. E.H ka filluar marrëdhëniet e punës pranë AAPSK, në datë 01.12.2015, në detyrën si specialiste finance e buxheti. Gjatë seancës dëgjimore

znj. E.H ka deklaruar se dhe ajo i përket besimit mysliman dhe se znj. B.I duhet ta vërtetojë me fakte që e ka ofenduar.

Rezulton se ankuesja me e-mail-in datë 28.02.2024, ka kërkuar nga z. I.H që të merren masa administrative ndaj fyerjeve të znj. E.H, por pa përmendur shprehjet e përdorura, periudhën kur kanë ndodhur këto ngjarje dhe shkakun e përdorimit të këtyre shprehjeve.

Referuar Kallëzimit penal të bërë nga ankuesja në datë 27.02.2024, rezulton se i është drejtuar Prokurorisë me kërkesë penale për fyerje dhe shpifje kundër znj. E.H dhe do jetë organi i Prokurorisë që do të shprehet për këto akuza.

Bazuar në informacionin dhe aktet e administruara gjatë procedurës hetimore, rezulton se ky pretendim i znj. B.I kundrejt znj. E.H është i karakterit deklarativ dhe nuk mbështetet në prova konkrete. Për këtë arsye, Komisioneri vlerëson se pretendimet e ankueses kundër znj. E.H, për shkak të besimit fetar, nuk mund të provohen dhe nuk do bëhet objekt shqyrtimi në vijim të trajtimit të ankesës.

- *Lidhur me pretendimet e subjektit ankues kundër z. I.H, me detyrë Kryeadministrator i AAPSK-së.*

Ankuesja ka pretenduar se z. I.H ka urdhëruar ngritjen e grupit të kontrollit dhe i janë kontrolluar vetëm pasuritë e saj.

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar, rezulton se me Urdhrin nr. 40, datë 12.02.2024, të Ministrit të Brendshëm “*Për delegim të kompetencave*”, është urdhëruar:

“1. Delegimi i kompetencave të Kryeadministratorit të AAPSK, z. I.H, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Rendit dhe Sigurisë Publike, në Ministrinë e Brendshme.

2. Kompetencat e deleguara sipas pikës 1, të këtij urdhri, të ushtrohen deri në emërimin e Kryeadministratorit të AAPSK ose deri në shfuqizimin e këtij Urdhri”.

Me Urdhrin nr. 9, datë 08.01.2024 “*Për magazinimin e pasurive të luajtshme në magazinën e APSK-së*”, Kryeadministratori z. A.K ka urdhëruar 14 administratorët e pasurive, të kryejnë të gjithë procedurat e nevojshme për transportimin e pasurive të luajtshme të sekuestruara dhe të konfiskuara pranë magazinës së AAPSK, deri me datë 31.01.2024.

Bazuar në planin vjetor të AAPSK-së për kontrollin e pasurive, të miratuar me nr. 543, datë 07.02.2024, nga Kryeadministratori z. A.K, dhe në zbatim të tij, Kryeadministratori i caktuar në detyrë, z. I.H, me anë të e-mail-it datë 23.02.2024, ka njoftuar të gjithë administratorët e pasurisë se: “*Në zbatim të planit vjetor të kontrolleve të planifikuara nga AAPSK dhe me qëllim mirëmenaxhimin e pasurive në administrim, duke filluar nga dita e hënë, datë 26.02.2024, do të filloj aktiviteti i kontrolleve nga stafi i AAPSK. Në këtë kuadër, administrator znj. B.I, koordinoni me ekipin e kontrollit të përbërë nga z. M.H, z. E.R dhe znj. E.H dhe të vazhdohet sipas planit të kontrollit.*”.

Me Urdhrin nr. 117, datë 27.02.2024, *“Për kontrollin fizik të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”*, Kryeadministratori ka urdhëruar krijimin e komisionit për kontrollin e pasurive të sekuestruara sipas Vendimit nr. 148, datë 29.09.2020 të Gjykatës së Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me administrator znj. B.I, me përbërjen si më poshtë: 1. Z. M.H, Kryetar; 2. E.R, Anëtar; 3. Znj. E.H, Anëtar; 4. Administratori i pasurisë të vendosë në dispozicion të komisionit dokumentacionin e kërkuar.

Me shkresën nr. 717/1, datë 27.02.2024, Kryeadministratori ka miratuar autorizimin për kontrollin e pasurive të sekuestruara me Vendimin nr. 148, datë 29.09.2020 të Gjykatës së Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Me shkresën nr. 717/8, datë 02.05.2024, Komisioni, pas shqyrtimit të Observacionit të bërë nga znj. B.I me shkresën nr. 717/7, datë 28.03.2024, ka hartuar Raportin përfundimtar mbi aktverifikimet e kryra nga komisioni i ngritur me Urdhrin nr. 117, datë 27.02.2024.

Në këtë raport përfundimtar, Komisioni ka konstatuar se janë kryer shkeljet si më poshtë:

- a) Mospërbushje e detyrave;
- b) Mosrespektimi i përsëritur i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja shumë të rënda;
- c) Moszbatimi haptazi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale;
- d) Fshehja, tjetërsimi, konsumimi, dëmtimi apo shkatërrimi i sendeve për të cilat është marrë një vendim prej gjykatës, ose kryerja e veprimeve të tjera të bëra me qëllim që të mos ekzekutohet ose të pengohet ekzekutimi i vendimit gjyqësor;
- e) Në mënyrë direkte apo indirekte, nga veprimet dhe mosveprimet e sipërcituara, rezulton se subjektet kundrejt të cilëve është vendosur masa e sekuestros ndikojnë në menaxhimin apo administrimin e pasurive. Për sa më sipër, znj. B.I ka vepruar në kundërshtim me kuadrin ligjor rregullator duke shpërdoruar detyrën;
- f) Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike.

Komisioni ka propozuar: 1- Vlerësimin dhe miratimin nga ana e titullarit të institucionit, me cilësinë e punëdhënësit, të propozimit të zgjidhjes së menjëhershme të kontratës individuale të punës të lidhur ndërmjet punëdhënësit AAPSK dhe punëmarrësit znj. B.I, për shkelje të rënda dhe shkaqe të justifikuara, parashikuar nga neni 153 i Kodit të Punës.

Në vijim të trajtimit të këtij raporti përfundimtar, Kryeadministratori me datë 07.05.2024, ka bërë shënimet për z. Th dhe z. M.H, si vijon: *“ - Të bëhet urdhri i kryeadministratorit për dorëzimin e pasurisë që ka në administrim znj. B.I; - Të fillojë procedura për shkëputjen e marrëdhënies të punës, siç propozohet nga ekipi i kontrollit, duke respektuar përcaktimet ligjore për këtë qëllim dhe procedurat administrative për dorëzimin e pasurive; – Të vlerësohet implikimi dhe niveli i shpërdorimit të detyrës me synim referimin në prokurori”*.

Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar, rezulton se Kryeadministratori me Urdhrin nr. 245, datë 24.04.2024 *“Për kontrollin fizik të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”*, ka urdhëruar krijimin e komisionit për kontrollin e pasurive të konfiskuara sipas Vendimit nr. 7, datë 24.04.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me administrator z. E.B, të përbërë nga: 1. E.R, Kryetar; 2. E.B, Anëtar; 3. E.K, Anëtar. 4. Administratori i pasurisë të vendosë në dispozicion të komisionit dokumentacionin e kërkuar.

Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar, rezulton se Kryeadministratori me Urdhrin nr. 297, datë 14.05.2024 *“Për kontrollin fizik të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”*, ka urdhëruar krijimin e komisionit për kontrollin e pasurive në administrim nga znj. E.S, të përbërë nga: 1. Z. M.H, Kryetar; 2. E.R, Anëtar; E.S, Anëtar. 4. Administratori i pasurisë të vendosë në dispozicion të komisionit dokumentacionin e kërkuar.

Gjithashtu, Kryeadministratori me Urdhrin nr. 249, datë 29.04.2024, ka urdhëruar ngritjen e Komisionit¹⁰ të inventarizimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara. Sipas këtij urdhri objekt i inventarizimit do ishin pasuritë e pa inventarizuara sipas administratorëve të pasurive, si më poshtë: z. A.B, z. E.B, znj. K.A, znj. B.I, z. E.A, znj. E.O, znj. E.S, znj. R.SH, z. S.B dhe z. S.M.

Në ligjin nr. 34/2019 *“Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”*, i ndryshuar, neni 9, përcaktohet se: *“2. Kryeadministratori ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:*

a) drejton dhe organizon veprimtarinë e Agjencisë;

b) mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë që kryhet për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara;

ç) harton listën e administratorëve të pasurisë së sekuestruar, të punësuar pranë agjencisë, të cilën ia paraqet gjykatës, të paktën një herë në vit, brenda tremujorit të parë të vitit. ;

d) cakton ose kontraktin administratorët e pasurisë së sekuestruar me vendim gjykate ose urdhër administrativ;, ndërsa në nenin 11, pika 1, përcaktohet se: “Administratori i pasurisë së sekuestruar caktohet nga kryeadministratori i agjencisë”.

Në analizë të sa më sipër, rezulton se Kryeadministratori ka filluar punë në datë 12.02.2024, ndërkohë që Komisioni për kontrollin e pasurive të administruara nga znj. B.I është ngritur në datë 27.02.2024. Në këtë rast, Komisioneri vlerëson se për vetë kohën e shkurtër në detyrë të z. I.H dhe mosnjohjes personale me ankuesen, nuk ka pasur të mundur që të ngrinte grupin e kontrollit, me qëllimin për ta trajtuar ankuesen në mënyrë të pafavorshme. Kryeadministratori duke qenë i sapo emëruar në detyrë nuk ka qenë në dijeni të dinamikave të brendshme të punonjësve të institucionit, si dhe nuk ka qenë në dijeni nëse ka pasur ankesa të mëparshme nga znj. B.I kundër z. M.H dhe

¹⁰ M.H, Kryetar, E.R, S.S, E.K, S.I, Anëtarë.

znj. E.H. Gjithsesi, rezulton se kërkesa dhe ankesa konkrete të ankueses kundrejt institucionit dhe punonjësve të tij ka pasur vetëm pasi është ngritur komisioni i kontrollit.

Komisioneri vlerëson se nuk ka tagër dhe ekspertizë për të vlerësuar përmbajtjen e raportit të hartuar nga Komisioni për kontrollin e pasurive me administrator znj. B.I, por konstaton se z. I.H në përmbushje të funksioneve të tij si Kryeadministrator ka urdhëruar ngritjen dhe dy Komisione të tjera për kontrollin e pasurive në administrim të z. B dhe znj. S, për të cilat nuk kuptohet qartë praktika, pasi administratorët e pasurive janë dhe pjesë e përbërjes së këtyre komisioneve.

Gjithashtu, rezulton se Kryeadministratori ka urdhëruar inventarizimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, si për ankuesen dhe për nëntë administrator të tjerë të pasurive.

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar, rezulton se nga ana e Kryeadministratorit të AAPSK është ndjekur e njëjta procedurë për kontrollin fizik të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, si për ankuesen po ashtu dhe për dy administratorët e pasurive, z. E.B dhe znj. E.S. Gjithashtu, rezulton se Kryeadministratori ka ndjekur të njëjtën procedurë për inventarizimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, si për ankuesen dhe për nëntë administrator të tjerë të pasurive.

Pra, në këtë rast konstatohet se ankuesja është në të njëjtat kushte me administratorët e tjerë pasurive të AAPSK, të cilët i janë nënshtruar procedurës së kontrollit fizik dhe inventarizimit të pasurive në administrim dhe nga ana e z. I.H nuk ka pasur një trajtim të pabarabartë të ankueses në raport me administratorët e tjerë.

- *Lidhur me pretendimin e subjektit ankues kundër Kryeadministratorit z. I.H, për mosmarrjen në shqyrtim të ankesave për fyerje dhe ofendime të përdorura nga znj. E.H.*

Ankuesja ka pretenduar se me e-mail-in datë 28.02.2024, ka informuar Kryeadministratorin se: “.... Ju rikujtoj që të merrni masa administrative për fyerjet që janë bërë ndaj meje, nga anëtarja e komisionit znj. E.H, shkak për të cilin ajo është në konflikt interesi, që përbën shkak për skualifikim nga komisioni në rastin tim”.

Gjithashtu, ankuesja në observacionin nr. 717/7, datë 28.03.2024, mbi akt verifikimet e mbajtura nga Komisioni ka përsëritur pretendimin se: “fq.1: Ju rikujtoj që të merrni masa administrative për fyerjet që janë bërë ndaj meje, nga anëtarja e komisionit znj. E.H, shkak për të cilin ajo është në konflikt interesi që përbën shkak për skualifikim nga komisioni në rastin tim; fq.9: Me çfarë të drejte dhe ku e gjen guximin Znj. E.H të fyej Administratorin e Pasurisë në prani të vartësve”.

Në lidhje me këtë pretendim të ankueses, AAPSK, nuk paraqiti asnjë shpjegim dhe nuk mbajtën asnjë qëndrim në parashtrimet e tyre. Në mënyrë specifike, Komisioneri kërkoi nga AAPSK që të parashtronin jo vetëm qëndrimin e tyre në lidhje me këtë pretendim të ankueses, por edhe të vinin në dispozicion informacionin e nevojshëm në lidhje me këtë çështje.

Ankuesja në mënyrë të përsëritur ka informuar me shkrim Kryeadministratorin për fyerjet dhe ofendimet e përdorura nga znj. E.H kundrejt saj, por nga ana e Kryeadministratorit nuk janë marrë masa për verifikimin dhe shqyrtimin e këtij pretendimi të znj. B.I.

Referuar kuadrit ligjor të veprimtarisë së brendshme të institucionit të AAPSK- së, Rregullores nr. 1363, datë 22.04.2021 *“Për organizmin e punës në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”*, rezulton se nuk ka të parashikuar asnjë procedurë shqyrtimi, lidhur me trajtimin e kërkesave/ankesave të punonjësve, për përdorimin e gjuhës ofenduese ose diskriminuese.

Në këtë rast, Komisioneri do ti rekomandojë institucionit të AAPSK, që të parashikojë procedura konkrete për trajtimin e kërkesave/ankesave të punonjësve.

- *Lidhur me pretendimin e subjektit ankues kundër Kryeadministratorit z. I.H, për mosmarrjen në shqyrtim të kërkesës së saj për përjashtimin nga Komisioni të znj. Znj. E.H dhe z. M.H, me arsyen se kanë konflikt interesi.*

Ankuesja pretendon se në komunikimet verbale me Kryeadministratorin z. I.H por dhe në observacionin nr. 717/7, datë 28.03.2024, mbi akt verifikimet e mbajtura nga Komisioni ka përsëritur pretendimin se: *“fq.9: Z. M.H dhe znj. E.H janë në konflikt interesi me mua për shkakun që bashkëshorti im ka kryer ankesën me prokurën e dhënë nga të gjithë administratorët për përfitimin me të padrejtë të shtesave të pagës që ju takojnë administratorëve”*.

Në lidhje me këtë pretendim, Kryeadministratori z. I.H është shprehur se: *“Në momentin e komunikimit për fillimin e procesit të kontrollit, është fakt që znj. B.I ka kërkuar verbalisht, me gojë, largimin e znj. E.H dhe të z. M.H nga ekipi i kontrollit, me pretendimin se ka konflikt interesi, por pa shpjeguar natyrën e këtij konflikti. Nga ana e kryeadministratorit, para fillimit të procesit të kontrollit dhe me marrjen e kësaj kërkesë është mbajtur takim në sallën e mbledhjeve, në ambientet e agjencisë, me personat e caktuar në ekipin e kontrollit dhe në praninë e znj. B.I, ku janë kërkuar sqarimet dhe janë, dëgjuar pretendimet e palëve rreth konfliktit të mundshëm të interesit. Gjithashtu, në këtë takim, nga ana e kryeadministratorit, u është kërkuar dy përgjegjësve të sektorit, nëse është e mundur rishikimi i përbërjes së ekipit, nisur nga kërkesa e znj. B.I, pavarësisht nëse ka apo jo argumente. Nga ana e anëtarëve të ekipit të kontrollit është deklaruar se nuk kanë konflikt interesi dhe për këtë kanë plotësuar deklaratën përkatëse. Nga ana e përgjegjësve të sektorëve, u argumentua pamundësia e zëvendësimit të tyre, për shkak të numrit të vogël të personelit dhe vakancave të shumta në personelin e agjencisë. Në kushtet e mos konstatimit të gjendjes së konfliktit të interesit, nga ana e pjesëtarëve, ekipi filloi zbatimin e kontrollit”*.

Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar rezulton, se pretendimi për konflikt interesi i znj. B.I kundrejt dy anëtarëve të komisionit, nëpërmjet Kallëzimit Penal datë 27.02.2024 dhe me email datë 28.02.2024, është bërë pas ngritjes së Komisionit në datë 27.02.2024. Rezulton se përpara kësaj

date, në AAPSK nuk ka pasur të administruar ndonjë ankesë/kërkesë nga ana e ankueses në drejtim të z. M.H dhe znj. E.H.

Bazuar në deklaratimet e palëve, rezulton se nga ana e Kryeadministratorit, pretendimi i ankueses është shqyrtuar në fillim të procesit të kontrollit të pasurive në administrim dhe është shtruar për diskutim me palët dhe në përfundim të vlerësimit të rastit, duke qenë se nga ana e z. M.H dhe znj. E.H, është mohuar fakti i pasjes së konfliktit të interesit me znj. B.I dhe janë plotësuar dhe formularët e deklaratimit të konfliktit të interesit, ka vlerësuar për vijimin e ushtrimit të kontrollit të pasurive të administruara nga znj. B.I me të njëjtën përbërje të komisionit.

Gjithashtu, në raportin përfundimtar nr. 717/8, datë 02.05.2024, Komisioni i ka kthyer përgjigje ankueses duke e informuar se: *“fq.6. Asnjë nga anëtarët e grupit të kontrollit nuk është në konflikt interesi me ju si punonjëse, me bashkëshortin tuaj i cili përfaqëson me prokurë të posaçme në një proces gjyqësor në të cilin keni paditur AAPSK, i cili si person juridik publik ka personalitetin e tij dhe përfaqësohet nga Kryeadministratori, ndërsa në gjykim nga përfaqësues të Sektorit Juridik. Grupi i kontrollit ju bën me dije se: Deklarata e konfliktit të interesit është nënshkruar nga anëtarët e komisionit dhe ruhet në dosjen e auditimit, këto deklarata janë individuale dhe bëhen përpara Kryeadministratorit dhe nuk kanë lidhje me deklaratim përpara subjektit të kontrollit, konkretisht znj. B.I. Për sa më sipër theksojmë se, asnjë nga anëtarët e komisionit, nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit, sipas vetë përcaktimeve të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005”.*

Në ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, i ndryshuar, parashikohet se:

“Neni 6/2 “Çdo epror dhe institucion epror duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe zgjidhur rastet e konfliktit të interesit”; Neni 7/3 “Vetëdeklarimi ose deklarimi me kërkesë bëhet si rregull me shkrim, kur zyrtari përfshihet në një vendimmarrje për një akt. ...”; Neni 10/1 “Autoriteti ose struktura përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji, sipas nenit 41 pika 2 të tij, në përputhje me masën, mënyrën dhe radhën e përcaktuar në këtë ligj dhe/ose në aktet nënligjore e rregulloret e brendshme të një institucioni publik, të nxjerra në zbatim të këtij ligji, është i autorizuar që, në mënyrë aktive, në emër të institucionit publik përkatës: a) të mbledhë, nga burimet e ligjshme të informacionit, të dhëna për interesat privatë të një zyrtari; b) të pranojë informacionet e siguruara në mënyrë të ligjshme; c) të verifikojë besueshmërinë e këtyre informacioneve; ç) të vërë në dijeni zyrtarin për informacionet e siguruara për të; d) t’i japë mundësi zyrtarit të provojë të kundërtën, nëse ky i fundit e kërkon një gjë të tillë;”;

Neni 37.

Për parandalimin sa më të hershëm dhe sa më efikas të çdo konflikti interesi, të çdo lloji qoftë ai:
1. Zyrtari, në ushtrimin e funksioneve të tij, paraprakisht, sipas rrethanës, nevojës, në mënyrë të shkallëzuar ose në proporcion me rëndësinë e situatës, mënjanon dhe zgjidh vetë çdo situatë të konfliktit të interesit, të çdo forme qoftë ajo, duke përdorur, sipas rastit dhe përshtatshmërisë, një apo disa nga mënyrat e mëposhtme: a) duke transferuar a tjetërsuar interesat privatë; b) duke u

vetëpërfjashtuar paraprakisht nga procesi konkret i vendimmarrjes, me përjashtim të rasteve kur është e pamundur delegimi i kompetencave të zyrtarit të një zyrtar tjetër, për shkak të ligjit apo për shkak të situates ose në rastet e organit kolegjial, duke mos marrë pjesë në diskutimin dhe votimin e çështjes në konflikt. 2. Zyrtari njofton eprorin ose institucionin epror, sipas rastit, për zgjidhjen e sugjeruar ose të marrë dhe provon e dokumenton këtë zgjidhje.

4. Eprori i zyrtarit ose institucioni epror, duke filluar nga ai më i afërt, paraprakisht, sipas rrethanës, nevojës, në mënyrë të shkallëzuar ose në proporcion me rëndësinë e situatës, mënjanon dhe zgjidh çdo situatë të konfliktit të interesit të një zyrtari vartës, të çdo forme qoftë ajo, duke përdorur, sipas rastit dhe përshtatshmërisë, një apo disa nga mënyrat e mëposhtme:

- a) t'i kufizojë zyrtarit informacione të caktuara, që lidhen me ushtrimin e funksionit të tij;
- b) të mos i ngarkojë zyrtarit detyra që mund të çojnë në shfaqjen e një konflikti interesash;
- c) të mos lejojë që zyrtari të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes;
- ç) të rishikojë ose të ndryshojë detyrat dhe kompetencat e zyrtarit;
- d) ta transferojë zyrtarin në një detyrë tjetër, që shmang konfliktin e interesave;
- dh) të marrë masat e nevojshme për të shmangur emërimin ose zgjedhjen e një zyrtari në funksione, në të cilat mund të lindin ose ka konflikte interesash;
- e) në rast të një akti të marrë në praninë e konfliktit faktik të interesit, në çdo mënyrë që kjo vihet re, të anulojë ose të revokojë, nëse e ka këtë kompetencë, aktet e marra nga zyrtari, sa më parë që të jetë e mundur, dhe mundësisht para se ato të kenë sjellë pasoja;
- ë) anulimi ose revokimi i aktit mund të bëhet edhe kur gjykohet se akti është marrë në kushtet e konfliktit në dukje të interesit, i cili mund të shfaqet rast për rast ose në mënyrë të vazhdueshme;
- f) anulimi ose revokimi i një akti nuk bëhet nga eprori kur ai vlerëson se pasojat që mund të vijnë nga anulimi ose revokimi i tejkalojnë dukshëm përfitimet nga ky anulim ose revokim.

6. Zyrtari lejohet të ushtrojë funksion dhe të kryejë detyrën me kusht që konflikti i vetëm i interesit i pashmangshëm është ai në dukje kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

- a) kur ai:
 - i) ose është i pazëvendësueshëm në ushtrimin e funksioneve;
 - ii) ose vetëpërfjashtimi i tij është i pamundur, sipas shkronjës "b" të pikës I të këtij neni;
 - iii) ose asnjëra nga zgjidhjet e pikës 4 të këtij neni nuk është e mundur;
- b) dhe kur:

i) vendimet e tij, sipas rregullimeve me ligj, nuk i nënshtrohen miratimit, revokimit ose shfuqizimit nga një institucion epror;

ii) nuk është i mundur as tjetërsimi i interesit privat, sipas shkronjës “a” të pikës I të këtij neni, për shkak të natyrës së tij (si lidhje familjare, komunitare etj.);

iii) nuk ka kuptim, që për një rast konflikti të tillë, ai të japë detyrimisht dorëheqjen nga funksioni. Në një rast të tillë, vendimet e këtij zyrtari i nënshtrohen një kontrolli dhe vlerësimi të veçantë nga institucionet e ngarkuara me ligj për të kryer kontrollin e këtyre vendimeve. Vendimi dhe rezultatet e kontrollit bëhen kurdoherë publike.

Neni 41.

Autoritetet përgjegjëse për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e gjendjeve të konfliktit të interesave.

1. Autoriteti qendror përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe që përmendet në këtë ligj me shkurtimin “Inspektorati i Lartë”. Inspektorati i Lartë, vihet në lëvizje me kërkesë të institucioneve publike, palëve të interesuara dhe kryesisht me nismën e tij.

2. Autoriteti ose strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji në institucionet publike janë:

a) eprorët e zyrtarëve, sipas hierarkisë, brenda një institucioni publik;

b) drejtoritë, njësitë e burimeve njerëzore apo njësi të ngarkuara a të ngritura posaçërisht, sipas nevojës dhe mundësive të çdo institucioni publik;

c) institucionet eprorë”.

Bazuar në parashikimet e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të ngrejë pretendime lidhur me interesat privatë dhe kushtet për ekzistencën e konfliktit të interesit të një zyrtari.

Bazuar në nenin 6/2 të ligjit sipërcituar, përcaktohet që çdo epror duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe zgjidhur rastet e konfliktit të interesit.

Komisioneri cilëson se nuk ka tagër dhe ekspertizë për të vlerësuar konfliktin e interesit të zyrtarëve publikë, pasi këtë funksion e ushtron Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, por bazuar në deklaratimet e palëve vlerëson se fakti që paditës janë 11 administratorë të pasurive nuk e vendos *prima facie* z. R.I si përfaqësues ligjor të tyre në konfliktin e interesit me z. M.H dhe znj. E.H, e për rrjedhojë as ankuesen.

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar, rezulton se pas vënies në dijeni nga ankuesja për pretendimin e saj për konfliktin e interesit të z. M.H dhe znj. E.H, Kryeadministratori z. I.H ka

trajtuar/shqyrtuar rastin duke vënë në dijeni z. M.H dhe znj. E.H, duke i pyetur ata lidhur me pretendimin e znj. B.I për konflikt interesi, dhe pasi ka marrë përgjigjen e tyre negative dhe plotësimin e formularit të deklarimit të konfliktit të interes për rastin në fjalë, ka vlerësuar se zyrtarët nuk ishin në kushtet e konfliktit të interes dhe mund të vazhdonin me detyrën e ngarkuar si anëtarë të komisionit për kontrollin e pasurive të sekuestruara në administrim të znj. B.I.

Komisioneri, vëren se, çdo person, kur vlerëson se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ligji 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka të drejtë të ankohet tek Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, si Autoriteti Qendror Përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.

Nga analiza e provave të vëna në dispozicion nga palët, Komisioneri vlerëson se nuk kemi një trajtim të pafavorshëm të subjektit ankues, pasi rezulton se Kryeadministratori i AAPSK, ka marrë masat për trajtimin/shqyrtimin e pretendimit të znj. B.I lidhur me konfliktin e interesit të anëtarëve të komisionit, z. M.H dhe znj. E.H.

- *Lidhur me pretendimin e subjektit ankues kundër Kryeadministratorit z. I.H, për mosmarrjen e masave për udhëtimin për në Vlorë/Himarë vetëm me ndihmësin z. Gj.Xh.*

Ankuesja pretendon se titullari Z. I.H, e ka detyruar të udhëtoj për ekzekutim (datë 17.04.2024), vetëm me ndihmësin Z. Gj.Xh, pavarësisht se ia ka bërë të qartë, kërkesën (email) për të pasur një kolege femër pjesëmarrëse në ekzekutim, kërkesë e cila nga drejtuesit e mëparshëm ka gjetur mirëkuptim, duke marrë parasysh dhe besimin e saj fetar dhe pasi i kishte komunikuar verbalisht disa herë z. I.H shqetësimet seksuale të z. Gj.Xh.

Lidhur me këtë pretendim, AAPSK ka informuar se, znj. B.I ka bërë kërkesë për shërbim bashkë me ndihmësin e saj dhe në asnjë moment nuk është shprehur që kërkon shoqërues të tjerë. Në përfundim të shërbimit është dorëzuar një informacion në lidhje me ekzekutimin e shërbimit nga ana e znj. B.I dhe nuk është ngritur asnjë pretendim që gjatë kohës së kryerjes së shërbimit ka pasur shqetësime nga ana e z. Gj.Xh.

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar rezulton se, me shkresën nr. 642, datë 20.02.2024, znj. B.I ka kërkuar rinovimin e kontratës të ndihmës administratorit z. Gj.Xh dhe mes palëve (AAPSK) dhe z. Gj.Xh është lidhur kontrata individuale e punës me nr. 642/1, datë 20.02.2024, me afat të caktuar deri në datë 19.08.2024.

Znj. B.I me kërkesën nr. 1341, datë 17.04.2024, drejtuar Përgjegjësit të Sektorit z. M.H, ka kërkuar miratimin e kërkesës për lëvizje në datë 17-18.04.2024, për në Himarë, për ekzekutimin e pasurisë së sekuestruar me Vendimin nr. 09, datë 16.02.2024, me përbërje grupi znj. B.I dhe z. Gj.Xh.

Me shkresën nr. 1341/1, datë 17.04.2024, Kryeadministratori ka autorizuar shërbimin e mësipërm dhe furnizimin me karburant për mjetin me të cilin do udhëtonte grupi i punës.

Znj. B.I me e-mail-in datë 17.04.2024, ora 08.32, drejtuar z. M.H dhe për dijeni z. I.H në mes të tjerash ka informuar se: “.... Në lidhje me ndihmësadministratorin, unë si administratore e vlerësoj që ai të qëndroj në zyrë për të kryer detyrat e përcaktuara në rregulloren e AAPSK-së dhe jam në pritje të relacionit të detyrave që ai ka kryer. Nëse specialisti i marrjes në administrim të pasurive nuk është në institucion (pasi mund të jetë me leje) kërkoj prezencën e një administratori. ...”.

Me shkresën nr. 1250/1, datë 19.04.2024, znj. B.I i ka dërguar z. I.H informacionin në lidhje me ekzekutimin e Vendimit nr. 09, datë 16.02.2024, në të cilin ka informuar lidhur me ekzekutimin e vendimit dhe veprimet e kryera nga grupi i punës dhe është mbajtur procesverbali i ekzekutimit të vendimit datë 17.04.2024, ora 14.00, në të cilin kanë firmosur përfaqësuesit e AAPSK, znj. B.I dhe z. Gj.Xh dhe oficerët e policisë gjyqësore, z. E.H dhe z. E.Xh.

Në analizë të dokumentacionit të shqyrtuar, nuk rezulton që znj. B.I të ketë vënë në dijeni Kryeadministratorin lidhur me pretendimin e saj për ngacmim/shqetësim nga ana e z. Gj.Xh për arsye të bindjes fetare.

Referuar dokumentacionit të sipërcituar, rezulton se kërkesa dhe autorizimi për shërbim janë bërë në datë 17.04.2024, procesverbali për ekzekutimin e vendimit, është mbajtur në Dhërmi në datë 17.04.2024, ora 14.00, ndërkohë që emaili i dërguar nga znj. B.I drejtuar z. M.H, në të cilën ka vlerësuar që ndihmësadministratori të qëndronte në zyrë, është bërë në datë 17.04.2024, pra në të njëjtën ditë kur ishte planifikuar për tu ekzekutuar shërbimi dhe drejtuesit e institucionit kanë qenë në pamundësi objektive për të trajtuar kërkesën e znj. B.I që ndihmësadministratori të qëndronte në zyrë dhe të caktohej një administrator tjetër.

Bazuar në informacionin dhe aktet e administruara gjatë procedurës hetimore, rezulton se pretendimi i znj. B.I për vënien në dijeni të Kryeadministratorit për ngacmim/shqetësim nga ana e z. Gj.Xh është i karakterit deklarativ dhe nuk mbështetet në prova konkrete. Për këtë arsye, Komisioneri vlerëson se znj. B.I nuk i është nënshtruar një trajtimi të pafavorshëm nga ana e z. I.H.

- *Lidhur me pretendimin e ankueses për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës nga ana e AAPSK.*

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar sipas rendit kronologjik, rezulton se:

Me shkresën nr. 717/8, datë 02.05.2024, Komisioni, pas shqyrtimit të Observacionit të bërë nga znj. B.I me shkresën nr. 717/7, datë 28.03.2024, ka hartuar Raportin përfundimtar mbi aktverifikimet e kryra nga komisioni i ngritur me Urdhrin nr. 117, datë 27.02.2024 dhe ka propozuar: 1- Vlerësimin dhe miratimin nga ana e titullarit të institucionit, me cilësinë e punëdhënësit, të propozimit të zgjidhjes së menjëhershme të kontratës individuale të punës të lidhur ndërmjet punëdhënësit AAPSK dhe punëmarrësit znj. B.I, për shkelje të rënda dhe shkaqe të justifikuara, parashikuar nga neni 153 i Kodit të Punës.

Në vijim të trajtimit të këtij raporti përfundimtar, Kryeadministratori me datë 07.05.2024, ka bërë shënimet për z. Th dhe z. M.H, si vijon: “- Të bëhet urdhri i kryeadministratorit për dorëzimin e

pasurisë që ka në administrim znj. B.I; - Të fillojë procedura për shkëputjen e marrëdhënies të punës, siç propozohet nga ekipi i kontrollit, duke respektuar përcaktimet ligjore për këtë qëllim dhe procedurat administrative për dorëzimin e pasurive; – Të vlerësohet implikimi dhe niveli i shpërdorimit të detyrës me synim referimin në prokurori”.

Referuar raporteve mjekësorë të lëshuar nga Qendra Shëndetësore Shkozë, për periudhën nga data 08.05.2024 deri me datë 20.07.2024, znj. B.I ka qenë me raport mjekësor për paaftësi në punë për sëmundje të përgjithshme që paguhen nga punëdhënësi dhe pas kësaj date ajo nuk është paraqitur në punë.

AAPSK me shkresën nr. 1771, datë 10.05.2024, ka njoftuar znj. B.I për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra”, referuar rekomandimeve të lëna nga KLSH, me raportin nr. 17/13, datë 04.10.2023¹¹.

Lidhur me dhënien e kësaj mase disiplinore, të bazuar në rekomandimin e raportit të KLSH-së, Komisioneri vlerëson se kjo masë është e pavlefshme, pasi është dhënë në një kohë të papërshtatshme kur znj. B.I ishte me raport paaftësie në punë dhe është dhënë në një kohë kur Kryeadministratori kishte miratuar raportin e komisionit në datë 07.05.2024 dhe kishte vënë shënimin për administratën, për fillimin e procedurave për shkëputjen e marrëdhënies të punës me znj. B.I. Rezulton se masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra”, nuk ka shërbyer si arsye për zgjidhjen e marrëdhënies të punës mes palëve. Në këtë kuptim masa e vendosur edhe pse e parregullt nuk ka gjeneruar efekte kundrejt ankueses.

Me shkresën nr. 3950, datë 29.07.2024, të AAPSK, znj. B.I është njoftuar për zhvillimin e mbledhjes në datë 01.08.2024, lidhur me vijimin e marrëdhënies të punës. Ankuesja ka marrë dijeni për shkresën nëpërmjet shërbimit postar (RR591250830AA) dhe me emailin datë 29.07.2024 të dërguar nga z. Q.Th me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Me urdhrin nr. 443, datë 30.07.2024, AAPSK ka urdhëruar ngritjen e komisionit për diskutimin e marrëdhënies të punës me znj. B.I, me përbërjen si vijon: z. Q.Th, Kryetar; z. M.H dhe znj. E.H, Anëtar.

Në datë 01.08.2024, Komisioni në mungesë të znj. B.I e cila nuk ishte paraqitur, ka mbajtur procesverbalin nr. 3950/2, datë 01.08.2024, në të cilin ka propozuar zgjidhjen e kontratës për shkaqet e mëposhtme:

1. Me shkresën me nr. 177, datë 10.05.2024, punëmarrësi ka marrë vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra, si rezultat i gjetjeve dhe rekomandimeve të lëna me raportin përfundimtar të KLSH me nr. 27/48, datë 05.10.2023.

¹¹ Referuar raportit përfundimtar të auditimit nr. 17/13, datë 04.10.2023, KLSH ka rekomanduar AAPSK-në, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të fillojë procedurat ligjore për dhënien e masave disiplinore “vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra”, edhe për znj. B.I, me detyrë administratorë të pasurive pranë AAPSK.

2. Me relacionin nr. 717/8, datë 02.05.2024 grupi i kontrollit i ngritur me urdhrin nr. 117, datë 27.02.2024, për kontrollin fizik të pasurive dhe mbi përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga KLSH për administratoren znj. B.I, u konstatua nga grupi i kontrollit që asnjë nga rekomandimet nuk ishte marrë parasysh, si dhe gjithashtu u gjetën mangësi në administrimin e pasurive.
3. Në relacionin me nr. 2670, datë 09.07.2024, mbi kontrollin fizik dhe marrjen në dorëzim të pasurive, që ishin në administrim të znj. B.I nga z. Gj. Z. Gj.Xh në cilësinë e administratorit konstatohen problematika nga më të ndryshmet dhe një administrim jo eficient në raport me qëllimin që ka AAPSK si institucion.
4. Nga periudha 08 maj deri me 21 korrik punëmarrësi është trajtuar, si i paaftë për punë, sipas raporteve shëndetësor të paraqitura përmes portalit E-AI. Në total 75 ditë paaftësi për punë. Periudhë e cila ndikon negativisht në vazhdimësinë e detyrave funksionale që ka administratori në AAPSK.
5. Pas përfundimit të periudhës së trajtuar me raport shëndetësor, prej datës 22.07.2024 punëmarrësi është njoftuar nga punëdhënësi me e-mail zyrtar, për tu paraqitur në punë. Nga listat e check-in (fletëhyrjet elektronike) të nxjerra nga sistemi rezulton se nga data 22.07.2024 deri me 31.07.2024, punëmarrësi nuk është paraqitur në punë pa ndonjë shkak të arsyeshëm.

Me Urdhrin nr. 459, datë 02.08.2024 *“Për zgjidhje të menjëhershme të kontratës individuale të punës”*, të AAPSK, është urdhëruar zgjidhja e menjëhershme e kontratës së punës me znj. B.I, pasi ka kryer shkelje: a) mospërmbushja e detyrave; b) moszbatimi haptazi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; c) braktisja e punës për më shumë se 7 ditë.

Ankuesja ka marrë dijeni për shkresën nëpërmjet shërbimit postar (RR648714753AA) dhe me emailin datë 07.08.2024 të dërguar nga z. Q.Th me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Referuar informacionit të palës ankuese dërguar Komisionerit me emailin datë 26.07.2024 dhe deklaramit të bërë gjatë seancës dëgjimore datë 14.08.2024, pala ankuese ka pranuar se ka marrë dijeni për njoftimet e AAPSK, por nuk ka pranuar që të paraqitet në punë, pasi ka pasur pretendimet e saj lidhur me detyrat dhe parregullsitë për trajtimin në vendin e punës.

Në vlerësim të sa më sipër cituar, vlerësohet se nga ana e AAPSK-së është ndjekur procedura e rregullt ligjore për zgjidhjen e kontratës së punës, pasi ankuesja është njoftuar dhe i është ofruar mundësia për tu mbrojtur dhe për të parashtruar fakte dhe prova në favorin e saj.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm gjatë procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës.

Në përfundim, Komisioneri gjatë analizës së informacionit dhe provave të sipërcituara, konstatoi se:

- Nga ana e z. B.B me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme, Kryeadministratorit z. I.H, Administratorit të Sektorit të Administrimit Ekonomik-Financiar

të Pasurive z. M.H dhe specialistes së financës znj. E.H, drejtues dhe punonjës të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK) janë ndjekur të gjithë procedurat dhe hapat, në mbështetje të akteve ligjore/nënligjore, për marrjen e masës disiplinore për ankuesen dhe znj. Islamaj ka pasur informacionin e duhur dhe mundësinë për tu ankuar për raportin e KLSH dhe të AAPSK-së.

- AAPSK, ka mbajtur të njëjtin qëndrim, për konstatimin e shkeljeve të akteve ligjore dhe nënligjore të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara gjatë procesit të verifikimit dhe inventarizimit të pronave të sekuestruara dhe konfiskuara.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si nga ligjet në fuqi”*.

Në nenin 12/1/c) të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimit dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”*.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7/1 të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjektet kundër të cilëve ishte drejtuar ankesa, nuk kanë ndërmarrë veprime që e kanë ekspozuar subjektin ankues ndaj një trajtimi të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e z. B.B, z. I.H, z. M.H dhe znj. E.H, për shkaqet e pretenduara nga ankuesja dhe për rrjedhojë nuk provohet se z. B.B, z. I.H, z. M.H dhe znj. E.H kanë shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, të subjektit ankues znj. B.I, në të drejtën për punësim, për shkak të *“gjinisë”*, *“bindjes fetare”*, *“pamjes së jashtme”* dhe *“çdo shkak tjetër”*, nga ana e z. B.B, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme, z. I.H, me detyrë Kryeadministrator, z. M.H, me detyrë Administrator i Sektorit të Administrimit Ekonomik-Financiar të Pasurive dhe znj. E.H, me detyrë specialiste finance, pranë Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara.
2. Rekomandohet që Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, të marrë masa për të rishikuar rregulloren dhe aktet e saj të brendshme në mënyrë që ato të parashikojnë procedura konkrete për trajtimin e kërkesave/ankesave për shqetësim në vendin e punës, diskriminimin apo përdorimin e gjuhës së papërshtatshme ose diskriminuese që paraqiten nga punëmarrësi.
3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara duhet të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA